

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: : **UNIVERSITETI HAXHI ZEKA NË PEJË**

Nr i Prokurimit **208/97400-26-6824-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **Renovimi i objektit të Rektoratit të Universitetit Haxhi Zeka**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NNP''CTA''SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

rr.Mehmet Gradica hy2 nr6

(Adresa)

Prishtine

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+383-44-507719

(Numri Telefonit)

(Numri)

ZIJA MORINA

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nnpcta@gmail.com

(Adresa elektronike)

27.07.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin **Renovimi i objektit të Rektoratit të Universitetit Haxhi Zeka** Njoftimi për kontratë është bërë me datën 15.08.2026
KERKESA PER RISHQYRTIM PER KRITERET E TENDERIT ESHTË BERE ME DATE 20.08.2026
VENDIMI I AK LIDHUR ME KERKESEN PER RISHQYRTIM nuk ka kthyer vendim AK

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Me datën **20.08.2026**, kemi parashtruar **Kërkesë për Rishqyrtim** lidhur me **Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit**, duke kundërshtuar kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues si të kundërligjshme dhe diskriminuese, për aktivitetin e prokurimit **Renovimi i objektit të Rektoratit të Universitetit Haxhi Zeka** me numër të prokurimit **208/97400-26-6824-5-2-1**. Njoftimi për Kontratë është përgatitur më **15.08.2026**.

Pas paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues, më datë **20.08.2026**, ka nxjerrë vetëm **Vendimin mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit**. Ky vendim nuk përbën vendim mbi **miratimin apo refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim**, por ka të bëjë vetëm me pezullimin e aktivitetit deri në trajtimin e kërkesës.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues **nuk ka nxjerrë dhe publikuar vendim mbi Kërkesën për Rishqyrtim brenda afatit ligjor**, si dhe nuk na ka njoftuar për ndonjë zgjatje të afatit për shqyrtimin e saj. Me date 26.08.2026 pas skadimit të afatit, AK paraqet vendimin mbi refuzimin e ankeses son te papabuar.

Për këtë arsye, në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe Rregullores për Prokurimin Publik, dhe pas skadimit të afatit ligjor për vendimmarrje nga Autoriteti Kontraktues, **i drejtohem Organit Shqyrtues të Prokurimit me këtë ankesë për shkak të mosveprimit të Autoritetit Kontraktues dhe njëkohësisht për shqyrtimin e pretendimeve të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim.**

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjate vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka zbatuar me përpikëri të gjitha dispozitat e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Përpos kësaj AK nuk ka respektuar as kërkesat e dosjes së tenderit të cilat vetë i ka parashtruar në fillim të këtij procesi të prokurimit. Dispozitat që ne mendojmë se AK i ka shkelur janë:

Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës:

- Neni 7;
- Neni 28;
- Neni 51;

- Neni 69.

Rregulloren për Prokurimin Publik Nr. 001/2022, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024:

- Neni 19.15(d);
 - Neni 19.16;
 - Neni 25.13;
 - Neni 25.17;
 - Neni 25.18.
-
- **nenit 61.1 të Rregullores për Prokurimin Publik**
 - **nenit 61.3 të Rregullores për Prokurimin Publik**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Gjatë shqyrtimit të Dosjes së Tenderit kemi konstatuar se një numër i kërkesave dhe specifikimeve teknike janë përcaktuar në mënyrë kufizuese, joproporcionale dhe pa arsyetim të mjaftueshëm teknik, duke krijuar pengesa të panevojshme për pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomikë dhe duke cenuar konkurrencën efektive në këtë procedurë të prokurimit.

Konsiderojmë se kriteret e tilla, në formën siç janë përcaktuar, nuk janë në përputhje me parimet themelore të prokurimit publik, veçanërisht me parimin e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, proporcionalitetit dhe sigurimit të konkurrencës së lirë dhe efektive, si dhe bien ndesh me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik dhe legjislacionit sekondar në fuqi.

Për këtë arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që t'i rishqyrtojë kriteret dhe specifikimet e kontestuara dhe t'i ndryshojë ato në mënyrë që të eliminohen kufizimet e pajustificuara dhe të sigurohet pjesëmarrje e barabartë, e hapur dhe gjithëpërfshirëse e Operatorëve Ekonomikë.

Në vijim paraqesim në mënyrë të veçantë pretendimet tona lidhur me secilën kërkesë të kontestuar.

Pretendimi nr. 30

Nxjerrja e vendimit mbi Kërkesën për Rishqyrtim pas afatit ligjor dhe mosnjoftimi i ankuesit për zgjatjen e afatit

Operatori Ekonomik ka paraqitur më **20.08.2026**, përmes platformës së e-Prokurimit, Kërkesë për Rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Renovimi i objektit të Rektoratit të Universitetit Haxhi Zeka**”, me numër të prokurimit **208/97400-26-6824-5-2-1**, të udhëhequr nga Autoriteti Kontraktues **UNIVERSITETI HAXHI ZEKA NË PEJË**.

Sipas **nenit 61.3 të Rregullores për Prokurimin Publik**, Autoriteti Kontraktues është i obliguar ta shqyrtojë Kërkesën për Rishqyrtim brenda **tre (3) ditëve të punës** nga data e paraqitjes së saj. Në raste specifike dhe të arsyetuara, ky afat mund të zgjatet deri në tri ditë shtesë, mirëpo ankuesi duhet të **njoftohet për zgjatjen e afatit**.

Në rastin konkret, duke e llogaritur datën **20.08.2026 si ditë zero**, afati i rregullt prej tri ditësh pune është:

- **21.08.2026 – dita e parë;**
- **24.08.2026 – dita e dytë;**
- **25.08.2026 – dita e tretë.**

Rrjedhimisht, afati i rregullt ligjor për vendimmarrje ka përfunduar më **25.08.2026**.

Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim më **26.08.2026**, me të cilin kërkesën e datës 20.08.2026 e ka refuzuar si të pabazuar. Vetë vendimi i AK-së mban datën 26.08.2026 dhe konfirmon se është nxjerrë lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim të datës 20.08.2026.

Pra, vendimi është nxjerrë **pas përfundimit të afatit të rregullt prej tri ditësh pune.**

Për më tepër, deri në skadimin e këtij afati, Operatori Ekonomik **nuk është njoftuar nga Autoriteti Kontraktues për ndonjë zgjatje të afatit të shqyrtimit**, ndonëse një njoftim i tillë kërkohet në rast se AK shfrytëzon afatin shtesë të paraparë me nenin 61.3.

Për rrjedhojë, çështja e kontestuar nuk është më mosnxjerrja e vendimit, pasi AK e ka nxjerrë atë më 26.08.2026, por **mosrespektimi i afatit të rregullt ligjor dhe mosnjoftimi i ankuesit për zgjatjen e afatit para skadimit të tij.**

Nxjerrja e vendimit më 26.08.2026 nuk e eliminon faktin se, deri më 25.08.2026, afati i rregullt kishte përfunduar pa vendim dhe pa njoftim për zgjatje.

Sipas **nenit 63.2 të Rregullores për Prokurimin Publik**, në rast se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk nxjerr vendim dhe nuk e njofton Operatorin Ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik fiton të drejtën t'i drejtohet OSHP-së pas skadimit të afatit të paraparë.

Kjo shkelje procedurale ka lindur **pas paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim**, prandaj objektivisht nuk ka mundur të përfshihet si pretendim në kërkesën fillestare të datës 20.08.2026.

Për këto arsye, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues **UNIVERSITETI HAXHI ZEKA NË PEJË** ka vepruar në kundërshtim me **nenin 61.3 dhe nenin 63.2 të Rregullores për Prokurimin Publik**, duke nxjerrë vendimin pas skadimit të afatit të rregullt prej tri ditësh pune dhe pa e njoftuar Operatorin Ekonomik për zgjatjen e afatit të shqyrtimit.

Prandaj kërkohet nga OSHP që ta konstatojë këtë shkelje procedurale dhe ta marrë parasysh gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së veprimeve të Autoritetit Kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit.

PRETENDIMI NR. 1

Kriter kufizues, joproportional dhe diskriminues lidhur me kërkesën për kontrata të veçanta për punë HVAC, renovim të kulmit dhe furnizim/montim të pajisjeve elektrike

Autoriteti Kontraktues, në kuadër të kërkesave mbi aftësinë teknike dhe/ose profesionale, ka përcaktuar kriterin si në vijim:

“Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, në vlerë prej jo më pak se 400,000.00 €. Punë të ngjashme – së paku një kontratë të përfunduar me referencë pozitive për instalime makinerike HVAC. Së paku një kontratë të përfunduar me referencë pozitive për renovime të kulmit.”

Ndërsa, në kuadër të **Dëshmisë nr. 1**, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar:

“Lista e kontratave të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë duhet të dorëzohet e skanuar origjinale, të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga OE, duke specifikuar emrin e projektit, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe të mbarimit të kontratës dhe referenca apo raporte të pranimit teknik. Së paku lideri të ketë një kontratë me furnizim dhe montim të pajisjeve elektrike. Referencat apo raportet e pranimit teknik duhet të korrespondojnë me listën e kontratave.”

Konsiderojmë se kërkesat sipas të cilave OE duhet domosdoshmërisht të ketë **së paku një kontratë të veçantë për instalime makinerike HVAC, së paku një kontratë të veçantë për renovime të kulmit, si dhe së paku lideri të ketë një kontratë me furnizim dhe montim të pajisjeve elektrike**, janë kufizuese, joproporcionale me qëllimin e kualifikimit dhe cenojnë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sipas **Nenit 7 të LPP-së – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi**, Autoriteti Kontraktues është i obliguar t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe nuk lejohet të zhvillojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën. Në veçanti, AK-së i ndalohet vendosja e një kërkesë apo kriteri të përzgjedhjes që favorizon ose diskriminon një apo më shumë operatorë ekonomikë.

Po ashtu, **Neni 51 i LPP-së** përcakton se kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në ato kritere që janë të nevojshme për të vërtetuar se operatori ekonomik posedon aftësitë profesionale, financiare dhe teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. Autoriteti Kontraktues nuk mund të përdorë kritere të tjera jashtë atyre të lejuara me nenet 65–70 të LPP-së.

Për më tepër, LPP përcakton se të gjitha kriteret e përzgjedhjes dhe dokumentet e kërkuara duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës përkatëse**.

Në rastin konkret, nuk kontestohet e drejta e Autoritetit Kontraktues që të kërkojë përvojë në realizimin e kontratave të një natyre të ngjashme. Megjithatë, kontestohet mënyra se si AK ka **fragmentuar përvojën e kërkuar**, duke kërkuar domosdoshmërisht kontrata specifike për kategori të veçanta të punimeve, përkatësisht HVAC, renovim të kulmit dhe, në kuadër të Dëshmisë nr. 1, furnizim dhe montim të pajisjeve elektrike.

Neni 25.13 i Rregullores Nr. 001/2022, i ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, përcakton se AK mund të kërkojë që OE të dëshmojë se në të kaluarën ka përfunduar **kontrata të një natyre të ngjashme**, dhe qartëson se kjo kërkesë mund të plotësohet përmes **një apo disa kontratave të një natyre të ngjashme**, të cilat vetëm ose së bashku arrijnë vlerën e kërkuar nga AK.

Pra, legjislacioni nuk e orienton kriterin drejt kërkesës që operatori të ketë realizuar kontrata me emërtim apo objekt identik dhe të veçantë për secilën kategori pune, por drejt vërtetimit të **përvojës së një natyre të ngjashme dhe aftësisë reale teknike për realizimin e kontratës së ardhshme**.

Një operator ekonomik mund të ketë realizuar, për shembull, një ose disa kontrata për renovim, rehabilitim apo ndërtim të objekteve, në kuadër të të cilave janë realizuar instalime makinerike HVAC, punime të kulmit, si dhe furnizim dhe montim të pajisjeve elektrike. Në këtë rast operatori posedon përvojën konkrete teknike në këto kategori të

punëve, pavarësisht se kontratat paraprake nuk kanë pasur si objekt të vetëm dhe ekskluziv “HVAC”, “renovimin e kulmit” apo “furnizimin dhe montimin e pajisjeve elektrike”.

Përjashtimi i një operatori të tillë vetëm për faktin se nuk posedon **kontrata autonome dhe të veçanta për secilën prej këtyre kategorive**, edhe pse mund të dëshmojë se punimet përkatëse janë realizuar me sukses si pjesë përbërëse e kontratave të ngjashme, nuk është proporcional me qëllimin që synohet të arrihet përmes kriterit të kualifikimit.

Në veçanti, kërkesa e vendosur në **Dëshminë nr. 1**, sipas së cilës:

“Së paku lideri të ketë një kontratë me furnizim dhe montim të pajisjeve elektrike”

paraqet një kusht shtesë kufizues, pasi aftësia dhe përvoja për furnizim dhe montim të pajisjeve elektrike mund të dëshmohet edhe nëpërmjet kontratave më të gjera të renovimit, rehabilitimit apo ndërtimit, ku këto punime kanë qenë pjesë e kontratës. Nuk ekziston arsye objektive që kjo përvojë të jetë fituar domosdoshmërisht përmes një kontrate të veçantë që ka pasur si objekt specifik furnizimin dhe montimin e pajisjeve elektrike.

Për më tepër, kushtëzimi që **pikërisht lideri i grupit** të posedojë një kontratë të tillë e ngushton edhe më tej konkurrencën, pasi në rast të një grupi operatorësh ekonomikë aftësitë teknike dhe profesionale mund të ekzistojnë brenda kapaciteteve të grupit, ndërsa një kufizim i tillë formal mund të eliminojë grupe operatorësh që, në tërësi, posedojnë kapacitetin dhe përvojën e nevojshme për realizimin e kontratës.

Edhe Udhëzuesi Nr. 001/2023 përcakton se gjatë formulimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK duhet të ketë kujdes që të mos përjashtojë operatorë ekonomikë që posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme, ndërsa të gjitha kërkesat minimale duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës**.

Gjithashtu, **Neni 69.6.2 i LPP-së**, për kontratat e punëve, lejon kërkimin e listës së projekteve dhe aktiviteteve ndërtimore të realizuara gjatë periudhës trevjeçare, të shoqëruara me certifikata që dëshmojnë përfundimin e kënaqshëm të punëve. Dispozita i referohet projekteve dhe aktiviteteve ndërtimore të realizuara dhe jo detyrimit që çdo kategori e veçantë e punëve të dëshmohet përmes një kontrate autonome dhe të veçantë.

Në këtë kuptim, kërkesat e AK-së janë më kufizuese sesa është e nevojshme për të vërtetuar aftësinë teknike të operatorit ekonomik dhe mund të rezultojnë në eliminimin e OE-ve që kanë përvojë të konsiderueshme në renovim dhe ndërtim të objekteve, përfshirë instalimet HVAC, punimet e kulmit dhe punimet elektrike, vetëm për shkak të mënyrës formale se si kanë qenë të strukturuar apo emërtuara kontratat e tyre paraprake.

Një kriter i tillë zvogëlon konkurrencën pa qenë e dëshmuar domosdoshmëria objektive që përvoja në këto kategori të punimeve të jetë fituar pikërisht përmes kontratave të veçanta.

Për këto arsye kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues:

1. Të ndryshojë kriterin lidhur me instalimet HVAC dhe renovimin e kulmit, duke mundësuar që përvoja për këto kategori të punimeve të dëshmohet edhe përmes kontratave të një natyre të ngjashme, në kuadër të të cilave këto punime kanë qenë

pjesë përbërëse e kontratës, pa kërkuar domosdoshmërisht kontratë të veçantë për secilën kategori;

2. **Të fshihet në tërësi nga Dëshmia nr. 1 kushti: “Së paku lideri të ketë një kontratë me furnizim dhe montim të pajisjeve elektrike”,** si kërkesë e panevojshme, kufizuese dhe joproporcionale, ose alternativisht të mundësohet që përvoja në furnizim dhe montim të pajisjeve elektrike të dëshmohet përmes çdo kontrate të një natyre të ngjashme në kuadër të së cilës këto punime janë realizuar si pjesë përbërëse;
3. Të ruhet vetëm kërkesa që lista e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit të përmbajë emrin e projektit, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe përfundimit, si dhe referencat, certifikatat apo raportet përkatëse të pranimi teknik, të cilat duhet të korrespondojnë me kontratat e paraqitura.

Kriteri mund të riformulohet si vijon:

“Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se gjatë tri viteve të fundit ka realizuar me sukses një apo më shumë kontrata të një natyre të ngjashme, në kuadër të të cilave janë realizuar punime relevante me objektin e kontratës, përfshirë instalime makinerike/HVAC, punime të renovimit të kulmit dhe, kur është relevante, furnizim dhe montim të pajisjeve elektrike. Përvoja mund të dëshmohet përmes kontratave në të cilat këto kategori të punimeve kanë qenë pjesë përbërëse, të mbështetura me referenca pozitive, certifikata, raporte të pranimi teknik apo dokumente të tjera të lejuara sipas LPP-së dhe Rregullores për Prokurimin Publik.”

PRETENDIMI NR. 2

– Kriter kufizues dhe diskriminues lidhur me kërkesën që certifikata për Siguri dhe Shëndet në Punë të jetë nga MFPT

Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar si kriter që:

“Inxhinieri i diplomuar Master i Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv, duhet të ketë minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit, të jetë i certifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë nga MFPT dhe të ketë Licencë A valide nga OIRK.”

Konsiderojmë se pjesa e kriterit **“të jetë i certifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë nga MFPT”**, e formuluar në këtë mënyrë ekskluzive, është kufizuese dhe diskriminuese, pasi e kushtëzon plotësimin e kërkesës me një burim të vetëm institucional të certifikimit, pa paraparë mundësinë e pranimi të certifikatave, trajnimeve apo dëshmive ekuivalente të lëshuara nga institucione, oda profesionale apo subjekte të tjera relevante dhe të autorizuar/licencuara për ofrimin e trajnimeve në këtë fushë.

Qëllimi i një kriteri të tillë duhet të jetë vërtetimi se profesionisti i propozuar posedon njohuritë dhe aftësimin përkatës në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe jo kufizimi formal që dëshmia të mbajë domosdoshmërisht emrin e një institucioni të vetëm.

Në rastin konkret, ekzistojnë profesionistë të licencuar në fushën e ndërtimit të cilët posedojnë trajnime relevante për **Mbrojtjen dhe Sigurinë në Punë në Fushën e Ndërtimit**, të organizuara nga institucione profesionale relevante, përfshirë Odën e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës. Përfshirja automatik e këtyre profesionistëve

vetëm për shkak se dëshmia e tyre nuk është lëshuar me emërtimin “nga MFPT”, pa u vlerësuar përmbajtja, relevanca dhe statusi i institucionit që ka ofruar trajnimin, e kufizon konkurrencën në mënyrë të panevojshme.

Në këtë drejtim, Rregullorja MPMS nr. 01/2021 rregullon jo vetëm kualifikimin e personave përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, por edhe **licencimin e kompanive të shërbimeve dhe trajnimeve për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë**, çka dëshmon se sistemi ligjor njih edhe subjekte të tjera që mund të ofrojnë trajnime në këtë fushë.

Po ashtu, Oda e Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit është institucion profesional me kompetenca të përcaktuara me ligj, ndër të cilat përfshihet edhe organizimi i edukimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional të inxhinierëve të licencuar.

Për rrjedhojë, kufizimi i kriterit vetëm në formulimin “**certifikuar nga MFPT**”, pa paraparë certifikime apo dëshmi ekuivalente të institucioneve të tjera relevante dhe të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi, nuk është proporcional me qëllimin e kriterit dhe mund të rezultojë në eliminimin e profesionistëve të kualifikuar që posedojnë aftësim relevant në të njëjtën fushë.

Një kërkesë e tillë duhet të vlerësohet edhe në raport me **Nenin 7 të LPP-së**, sipas të cilit Autoriteti Kontraktues duhet t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe nuk duhet të vendosë kërkesa që reduktojnë apo eliminojnë konkurrencën.

Po ashtu, sipas **Nenit 51 të LPP-së**, kriteret e përzgjedhjes dhe dëshmitë e kërkuara duhet të kufizohen vetëm në ato që janë të nevojshme për të vërtetuar aftësinë profesionale dhe teknike dhe duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës.

Për këto arsye kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të ndryshojë kriterin dhe të fshijë kufizimin ekskluziv “nga MFPT”, duke mundësuar pranimin edhe të certifikatave, kualifikimeve apo dëshmime ekuivalente të lëshuara nga institucione, oda profesionale ose subjekte të tjera relevante dhe të autorizuar/licencuara sipas legjislacionit në fuqi për trajnime në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

Kriteri propozojmë të riformulohet si vijon:

“Inxhinier i diplomuar Master i Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv, me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit, me Licencë A valide nga OIRK dhe me trajnim/kualifikim valid në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, të dëshmuar me certifikatë të lëshuar sipas legjislacionit në fuqi nga institucioni kompetent, institucion/organizatë profesionale apo subjekt i autorizuar/licencuar për ofrimin e trajnimeve përkatëse, ose dëshmi ekuivalente.”

PRETENDIMI NR. 3

– Kriter kufizues, joproporcional dhe diskriminues lidhur me kërkesën që Inxhinieri i Hidroteknikës të jetë i certifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë ekskluzivisht nga MFPT

Autoriteti Kontraktues, në kuadër të **Kërkesës 5**, ka përcaktuar:

“Një (1) Inxhinier i diplomuar Master i Ndërtimtarisë – drejtimi hidroteknikë duhet të ketë minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit dhe të jetë i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë nga MFPT. Të ketë Licencë A valide nga OIRK.”

Ndërsa, në kuadër të **Dëshmisë 5**, është kërkuar që:

“Inxhinieri i diplomuar i Ndërtimtarisë – drejtimi hidroteknikë duhet të ketë kontratë të punës valide ose parakontratë për angazhim për këtë projekt. Nëse nga OE prezantohen kontrata të rregullta të punës, ato duhet të dëshmohen edhe me listë të Administratës Tatimore në 6 muajt e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë. Nëse nga OE prezantohet parakontratë për angazhim për këtë projekt duhet të specifikohet titulli dhe numri i aktivitetit të prokurimit, certifikatat e kërkuara, CV e nënshkruar nga punonjësi me të dhëna të sakta, si dhe referencë për punët e mëparshme profesionale. Të prezantohet edhe certifikata përkatëse valide e kërkuar për këtë inxhinier.”

Konsiderojmë se pjesa e kriterit sipas së cilës Inxhinieri Master i Ndërtimtarisë – drejtimi hidroteknikë duhet të jetë **“i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë nga MFPT”**, e formuluar në mënyrë ekskluzive, është **kufizuese, joproporcionale dhe diskriminuese**, pasi plotësimi i kërkesës lidhet me një burim të vetëm institucional të certifikimit, pa lejuar certifikata, trajnime apo dëshmi ekuivalente të lëshuara nga institucione, oda profesionale apo subjekte të tjera relevante që janë të autorizuar/licencuara sipas legjislacionit në fuqi për organizimin e trajnimeve në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

Nuk kontestohet e drejta e Autoritetit Kontraktues që, kur kjo është relevante me lëndën e kontratës, të kërkojë që personeli profesional të posedojë njohuri dhe aftësim në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

Megjithatë, **qëllimi i kriterit duhet të jetë vërtetimi i njohurive, aftësimit dhe kompetencës profesionale të inxhinierit**, dhe jo kushtëzimi formal që certifikata apo dëshmia përkatëse të jetë lëshuar domosdoshmërisht vetëm “nga MFPT”.

Nëse legjislacioni në fuqi lejon që trajnime në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë të organizohen edhe nga persona juridikë, institucione apo subjekte të licencuara/autorizuara për këtë qëllim, atëherë përjashtimi apriori i certifikatave të lëshuara nga këto subjekte vetëm për shkak se në dokument nuk figuron MFPT si lëshues krijon një kufizim formal që nuk lidhet domosdoshmërisht me aftësinë reale profesionale të personit të propozuar.

Në këtë kuptim, mund të ekzistojnë inxhinierë të diplomuar të hidroteknikës, me mbi 5 vite përvojë profesionale pas diplomimit dhe me Licencë A valide nga OIRK, të cilët njëkohësisht kanë përfunduar trajnime relevante në fushën e **Sigurisë dhe Shëndetit në Punë**, por pranë institucioneve profesionale ose subjekteve të tjera të autorizuar për organizimin e këtyre trajnimeve.

Eliminimi i këtyre profesionistëve vetëm për faktin se dëshmia e trajnimit nuk është lëshuar drejtpërdrejt “nga MFPT”, pa u vlerësuar përmbajtja e trajnimit, vlefshmëria e certifikatës, kompetenca e institucionit lëshues dhe ekuivalenca e kualifikimit, është masë më kufizuese sesa është e nevojshme për realizimin e qëllimit të kriterit.

Një formulim i tillë mund të zvogëlojë numrin e profesionistëve të pranueshëm dhe, rrjedhimisht, edhe numrin e operatorëve ekonomikë që mund të marrin pjesë në aktivitetin

e prokurimit, pa u dëshmuar ndonjë domosdoshmëri objektive që certifikimi të jetë fituar ekskluzivisht nga një institucion i vetëm.

Sipas **Nenit 7 të LPP-së – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi**, Autoriteti Kontraktues është i obliguar t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe nuk duhet të vendosë kërkesa apo kritere që kanë për efekt reduktimin ose eliminimin e konkurrencës.

Po ashtu, sipas **Nenit 51 të LPP-së**, kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen në ato që janë të nevojshme për të vërtetuar aftësinë profesionale dhe teknike të operatorit ekonomik, ndërsa kriteret dhe dëshmitë e kërkuara duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës**.

Në rastin konkret, aftësia profesionale e Inxhinierit të Hidroteknikës tashmë kërkohet të dëshmohet përmes:

- diplomës Master në Ndërtimtari – drejtimi hidroteknikë;
- minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit;
- Licencës A valide nga OIRK;
- CV-së dhe referencave për përvojën profesionale;
- kontratës së punës ose parakontratës për angazhim.

Për rrjedhojë, nëse AK konsideron të nevojshëm edhe trajnimin në Siguri dhe Shëndet në Punë, kjo kërkesë duhet të formulohet në mënyrë që të verifikojë **kompetencën përkatëse**, pa kufizuar pranueshmërinë vetëm në një institucion të caktuar lëshues.

Për këto arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të ndryshojë Kërkesën 5 dhe të fshijë kufizimin ekskluziv “nga MFPT”, duke mundësuar që kriteri për Siguri dhe Shëndet në Punë të dëshmohet edhe me certifikata apo dëshmi ekuivalente të lëshuara nga institucione, oda profesionale, kompani apo subjekte të tjera relevante, të autorizuar/licencuara sipas legjislacionit në fuqi për ofrimin e trajnimeve përkatëse.

Propozojmë që kriteri të riformulohet si vijon:

“Një (1) Inxhinier i diplomuar Master i Ndërtimtarisë – drejtimi hidroteknikë, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, me Licencë A valide nga OIRK dhe me trajnim/kualifikim valid në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, të dëshmuar me certifikatë të lëshuar nga institucioni kompetent ose nga institucion, organizatë profesionale apo subjekt tjetër i autorizuar/licencuar sipas legjislacionit në fuqi për ofrimin e trajnimeve përkatëse, apo me dëshmi ekuivalente.”

PRETENDIMI NR. 4

Kriter i paqartë, kufizues, joproporcional dhe diskriminues lidhur me certifikimin/licencimin e Teknikut të Ndërtimtarisë

Autoriteti Kontraktues, në kuadër të **Kërkesës 9**, ka përcaktuar:

“Një (1) teknik i ndërtimtarisë të jetë i certifikuar apo licencuar për punë ndërtimore nga institucionet shtetërore.”

Ndërsa, në kuadër të **Dëshmisë 9**, ka kërkuar:

“Diploma e shkollës së mesme profesionale. Të sillet kopja e certifikatës për siguri në vend të punës, certifikata ose licencë nga ndonjë institucion shtetëror, CV e nënshkruar nga punonjësi me të dhëna të sakta, si dhe referencë për punët e mëparshme profesionale.”

Konsiderojmë se kriteri i mësipërm është **i paqartë, kufizues, joproportional dhe potencialisht diskriminues**, pasi Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar qartë se:

- çfarë lloj certifikate apo licence kërkohet për Teknikun e Ndërtimtarisë;
- cili institucion është kompetent për lëshimin e saj;
- cili është emërtimi zyrtar i certifikatës/licencës;
- mbi cilën bazë ligjore kërkohet një licencim i tillë për një person me kualifikim të shkollës së mesme profesionale;
- cilat aktivitete konkrete ndërtimore duhet të mbulojë kjo certifikatë apo licencë.

Formulimi i përgjithshëm **“certifikuar apo licencuar për punë ndërtimore nga institucionet shtetërore”** nuk u mundëson operatorëve ekonomikë të identifikojnë me siguri dokumentin që duhet të dorëzojnë për përmbushjen e kriterit dhe, si rezultat, krijojnë rrezik që dokumente të ndryshme të interpretohen në mënyrë të ndryshme gjatë procesit të vlerësimit.

Kjo paqartësi është veçanërisht problematike për faktin se vetë AK, si dëshmi të kualifikimit bazë të personit, ka kërkuar **diplomën e shkollës së mesme profesionale**, pra ka përcaktuar profilin si **Teknik i Ndërtimtarisë** dhe jo si Inxhinier i licencuar.

Legjislacioni që rregullon licencimin profesional në fushën e ndërtimit përcakton sistemin e licencimit për arkitektët dhe inxhinierët, ndërsa marrja e licencave profesionale A dhe B lidhet me përfundimin e studimeve akademike përkatëse. Për rrjedhojë, kërkesa që një Teknik i Ndërtimtarisë me shkollë të mesme profesionale të posedojë një “licencë për punë ndërtimore nga institucionet shtetërore”, pa identifikuar bazën konkrete juridike dhe dokumentin e kërkuar, është e paqartë dhe mund të jetë objektivisht e vështirë apo e pamundur për t'u përmbushur në formën në të cilën është shkruar.

Po ashtu, kufizimi i dokumentit vetëm të **“institucionet shtetërore”** është i panevojshëm nëse qëllimi i Autoritetit Kontraktues është të dëshmojë aftësimin profesional apo trajnimin e personit. Nëse ekzistojnë institucione profesionale, oda, organizata apo subjekte të autorizuar/licencuara sipas legjislacionit përkatës për organizimin e trajnimeve dhe lëshimin e certifikatave relevante, dokumentet e tyre nuk duhet të përjashtohen vetëm për shkak se institucioni lëshues nuk cilësohet formalisht si “institucion shtetëror”.

Sipas **Nenit 7 të LPP-së**, Autoriteti Kontraktues është i obliguar t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe nuk mund të zhvillojë aktivitetin e prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën.

Gjithashtu, sipas **Nenit 51 të LPP-së**, të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të përcaktohen në tërësi dhe të kufizohen vetëm në ato që janë të nevojshme për të vërtetuar aftësitë profesionale dhe teknike, ndërsa kriteret dhe dokumentet e kërkuara duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës**.

Mospërputhja ndërmjet Kërkesës 9 dhe Dëshmisë 9

Përveç kësaj, ekziston një mospërputhje e rëndësishme ndërmjet vetë kriterit dhe dokumenteve të kërkuara.

Në **Kërkesën 9** nuk është përcaktuar që Tekniku i Ndërtimtarisë duhet të posedojë certifikatë për Siguri dhe Shëndet në Punë, ndërsa në **Dëshminë 9** kërkohet shprehimisht:

“kopja e certifikatës për siguri në vend të punës”.

Në këtë mënyrë, përmes pjesës së dëshmimeve është vendosur një kërkesë shtesë materiale që nuk është specifikuar qartë në vetë kriterin e kualifikimit.

Dokumenti dëshmuar duhet të shërbejë për të **dëshmuar një kërkesë të përcaktuar paraprakisht**, dhe jo të krijojë një kriter të ri të kualifikimit përmes rubrikës së dëshmimeve. Neni 51 kërkon që kriteret dhe dokumentet përkatëse të përcaktohen në mënyrë të plotë në dokumentacionin e tenderit.

Për këto arsye kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues:

1. Të fshijë nga Kërkesa 9 kushtin:

“të jetë i certifikuar apo licencuar për punë ndërtimore nga institucionet shtetërore”,

për shkak se nuk është përcaktuar lloji i licencës/certifikatës, institucioni kompetent, baza ligjore dhe fushëveprimi i dokumentit të kërkuar.

2. Të fshijë ose të harmonizojë kërkesën për “certifikatë për siguri në vend të punës” nga Dëshmia 9, pasi një kërkesë e tillë nuk është paraparë në vetë Kërkesën 9.

3. Nëse AK konsideron të domosdoshëm një trajnim për Siguri dhe Shëndet në Punë, të lejojë certifikata të lëshuara jo vetëm nga institucione shtetërore, por edhe nga institucione, oda profesionale apo subjekte të tjera relevante dhe të autorizuar/licencuara sipas legjislacionit në fuqi për ofrimin e trajnimeve përkatëse.

Propozojmë që Kërkesa 9 të riformulohet:

“Një (1) Teknik i Ndërtimtarisë, me diplomë të shkollës së mesme profesionale në drejtimin përkatës, me përvojë relevante në punë ndërtimore, të dëshmuar përmes CV-së dhe referencave profesionale.”

Nëse AK e konsideron të nevojshëm trajnimin për siguri:

“Një (1) Teknik i Ndërtimtarisë, me diplomë të shkollës së mesme profesionale në drejtimin përkatës dhe me trajnim në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, të

dëshmuar me certifikatë valide të lëshuar nga institucion kompetent ose subjekt i autorizuar/licencuar sipas legjislacionit në fuqi.”

PRETENDIMI NR. 5

Kriter i paqartë, kufizues dhe joproporcional lidhur me bashkimin e dy profileve të ndryshme profesionale në një Teknik të vetëm të Makinerisë

Autoriteti Kontraktues, përmes **Njoftimit për Informata Shtesë/Përmirësim të Gabimit**, ka bërë korrigjime në kuadër të Kërkesës 11, duke larguar kërkesën që Tekniku i Makinerisë të jetë i certifikuar për siguri në vendin e punës, si dhe duke ndryshuar pjesën përkatëse të dëshmimeve.

Megjithatë, edhe pas këtij korrigjimi, në kuadër të **Kërkesës 11** ka mbetur kërkesa:

“Një (1) teknik i makinerisë – Instalues i ujësjellësit, kanalizimit, ngrohjes dhe klimatizimit.”

Ndërsa, si **DËSHMI 11**, kërkohet:

“Diploma të shkollës së mesme profesionale, CV e nënshkruar nga punonjësi me të dhëna të sakta, si dhe referencë për punët e mëparshme profesionale.”

Vlerësojmë pozitivisht faktin se Autoriteti Kontraktues ka larguar kërkesat e mëparshme lidhur me certifikimin për siguri në vendin e punës dhe dokumentet përkatëse, mirëpo **çështja kryesore e ngritur në këtë pretendim nuk është korrigjuar**, pasi vazhdon të kërkohet që një person i vetëm të mbulojë dy profile të ndryshme profesionale të drejtimit të Makinerisë, përkatësisht:

- **Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit; dhe**
- **Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit.**

Diplomat e shkollës së mesme profesionale përcaktojnë drejtimin dhe profilin konkret profesional të përfunduar nga kandidati. Për rrjedhojë, një Teknik i Makinerisë me diplomë në profilin **“Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit”** nuk mund të kushtëzohet që në të njëjtën diplomë të ketë të evidentuar edhe profilin **“Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit”**, dhe anasjelltas.

Bashkimi i këtyre dy profileve në një person të vetëm krijon një kërkesë të paqartë dhe kufizuese, pasi mund të përjashtojë teknikë të kualifikuar vetëm për shkak të emërimit të profilit që figuron në diplomën e tyre.

Për më tepër, formulimi aktual nuk e sqaron nëse AK kërkon që një diplomë e vetme të mbulojë njëkohësisht të dy profilet apo nëse kualifikimi në njërin prej tyre do të konsiderohet i mjaftueshëm. Një paqartësi e tillë mund të krijojë edhe mundësi për interpretim jo të njëtrajtshëm gjatë vlerësimit të ofertave.

Nëse Autoriteti Kontraktues ka nevojë vetëm për një Teknik të Makinerisë për punët e ngrohjes dhe klimatizimit, atëherë kërkesa duhet të kufizohet në këtë profil.

Nëse, ndërkaq, Autoriteti Kontraktues konsideron se për realizimin e kontratës janë të domosdoshme edhe punët e ujësjellësit dhe kanalizimit, atëherë ky kapacitet profesional

duhet të kërkohet përmes **një personi të dytë dhe profili të veçantë**, e jo duke kërkuar që një person i vetëm të posedojë dy profile të ndryshme profesionale.

Një kërkesë e tillë duhet të jetë në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe me nevojën reale të kontratës, në mënyrë që të mos kufizojë pa arsye pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të cilët posedojnë personel të kualifikuar për secilin profil profesional.

KËRKESA NDAJ AUTORITETIT KONTRAKTUES

Për këtë arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që **Kërkesën 11** ta ndryshojë në njërin nga këto dy forma:

Alternativa 1 – Të largohet profili i ujësjellësit dhe kanalizimit

Kërkesa 11 të riformulohet:

“Një (1) Teknik i Makinerisë – Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit, me diplomë të shkollës së mesme profesionale në profilin përkatës ose ekuivalent.”

Alternativa 2 – Nëse AK kërkon domosdoshmërisht edhe kapacitet profesional për ujësjellës dhe kanalizim, të ndahen në dy pozita

1. Një (1) Teknik i Makinerisë – Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit, me diplomë të shkollës së mesme profesionale në profilin përkatës ose ekuivalent;

dhe

2. Një (1) Teknik i Makinerisë – Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit, me diplomë ose kualifikim profesional në profilin përkatës ose ekuivalent.

Në këtë mënyrë, secili profesionist do të dëshmojë kualifikimin e tij përmes diplomës ose dokumentit profesional përkatës dhe nuk do të kërkohet në mënyrë joproporcionale që **një person i vetëm dhe një diplomë e vetme të mbulojnë dy profile të ndryshme profesionale.**

Prandaj, duke marrë parasysh edhe korrigjimin e bërë nga AK, kërkojmë që të korrigjohet edhe pjesa e mbetur e Kërkesës 11, duke larguar bashkimin e dy profileve profesionale në një person të vetëm. AK ose duhet ta kufizojë kërkesën vetëm në profilin që realisht i nevojitet kontratës, ose, nëse të dy profilet janë të domosdoshme, t'i parashohë ato si dy pozita të veçanta profesionale.

PRETENDIMI NR. 6

– Kriter kufizues dhe diskriminues lidhur me kërkesën që certifikatat shëndetësore të lëshohen vetëm nga institucione publike të mjekësisë së punës

Autoriteti Kontraktues, në kuadër të **Kërkesës 14**, ka përcaktuar:

“Së paku 10 punëtorë të kenë kontrata aktive apo parakontrata për këtë projekt, të kenë certifikata shëndetësore nga ndonjë institut i mjekësisë së punës – publike.”

Ndërsa si **DËSHMI** është kërkuar:

“CV e nënshkruar, kopje e kontratës valide apo parakontratës për këtë projekt dhe kopjet e certifikatave shëndetësore.”

Konsiderojmë se pjesa e kriterit me të cilën Autoriteti Kontraktues kërkon që certifikatat shëndetësore të jenë të lëshuara ekskluzivisht nga një institut i mjekësisë së punës **“publike”** është kriter kufizues, diskriminues dhe joproporcional, pasi përjashton pa bazë objektive institucionet private shëndetësore të cilat janë të licencuara dhe të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për ofrimin e shërbimeve nga mjekësia e punës.

Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, në dispozitat që rregullojnë kontrollimet mjekësore të të punësuarve, përcakton se punëdhënësi është i detyruar t'u sigurojë të punësuarve kontrollime mjekësore në **institucionet shëndetësore të licencuara për shërbime nga mjekësia e punës.**

Pra, kriteri ligjor është **licencimi dhe kompetenca e institucionit për ofrimin e shërbimeve të mjekësisë së punës**, dhe jo forma e pronësisë së institucionit.

Në këtë kuptim, legjislacioni nuk e kufizon vlefshmërinë e kontrollimeve apo certifikatave shëndetësore vetëm te institucionet publike.

Po ashtu, Ligji për Shëndetësi përcakton se institucionet shëndetësore mund të themelohen në format organizative dhe pronësore të lejuara me ligj dhe se institucionet shëndetësore mund të fillojnë punën pas licencimit nga Ministria ose organi i autorizuar prej saj.

Për rrjedhojë, një institucion privat shëndetësor që posedon **licencë valide për ofrimin e shërbimeve përkatëse të mjekësisë së punës** ushtron veprimtarinë mbi bazën e autorizimit të organit kompetent dhe dokumentet e lëshuara prej tij nuk duhet të përjashtohen vetëm për shkak të formës private të pronësisë.

Nëse qëllimi i Autoritetit Kontraktues është të sigurojë që 10 punëtorët e propozuar janë të aftë nga aspekti shëndetësor për kryerjen e punëve, ky qëllim përmbushet duke kërkuar certifikata shëndetësore të lëshuara nga **institucione të licencuara për mjekësi të punës**, pavarësisht nëse institucioni është publik apo privat.

Kufizimi shtesë **“publike”** nuk e rrit vlefshmërinë apo cilësinë juridike të certifikatës nëse edhe institucioni privat është i licencuar nga autoriteti kompetent për të njëjtin shërbim.

Përkundrazi, ky kufizim mund të ketë efekt të drejtpërdrejtë në reduktimin e konkurrencës, pasi operatorët ekonomikë që posedojnë certifikata valide për punëtorët e tyre, të lëshuara nga institucione private të licencuara të mjekësisë së punës, do të përjashtoheshin vetëm për shkak të pronësisë së institucionit lëshues.

Një dallim i tillë nuk lidhet me aftësinë shëndetësore të punëtorit dhe as me vlefshmërinë profesionale të kontrollimit mjekësor, por vetëm me statusin publik apo privat të institucionit që ka kryer kontrollimin.

Sipas **Nenit 7 të LPP-së – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi**, Autoriteti Kontraktues duhet t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe

nuk duhet të zhvillojë aktivitetin e prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën.

Gjithashtu, sipas **Nenit 51 të LPP-së**, kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të dëshmuar aftësinë profesionale dhe teknike të operatorit ekonomik dhe të gjitha kriteret dhe dokumentet e kërkuara duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës**.

Në rastin konkret, kërkesa për certifikatë shëndetësore mund të konsiderohet relevante me natyrën e punimeve dhe sigurinë e punëtorëve, mirëpo **kufizimi që certifikata duhet të jetë vetëm nga institucion publik nuk është i nevojshëm për arritjen e këtij qëllimi**.

KËRKESA NDAJ AUTORITETIT KONTRAKTUES

Për këto arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që nga **Kërkesa 14** të largohet fjala/kufizimi:

“publike”

dhe të mundësohet që certifikatat shëndetësore të pranohen nga **çdo institucion shëndetësor i licencuar dhe i autorizuar për ofrimin e shërbimeve të mjekësisë së punës, pavarësisht nëse është institucion publik apo privat**.

Kërkesa 14 propozojmë të riformulohet si vijon:

“Së paku dhjetë (10) punëtorë të kenë kontrata aktive apo parakontrata për angazhim në këtë projekt dhe të posedojnë certifikata shëndetësore valide të lëshuara nga institucion shëndetësor i licencuar për ofrimin e shërbimeve nga mjekësia e punës.”

Ndërsa dëshmia të mbetet:

“CV e nënshkruar, kopje e kontratës valide apo parakontratës për angazhim në këtë projekt dhe kopje e certifikatave shëndetësore valide të lëshuara nga institucioni shëndetësor i licencuar për shërbime nga mjekësia e punës.”

Në këtë mënyrë ruhet plotësisht qëllimi i ligjshëm i AK-së për verifikimin e aftësisë shëndetësore të punëtorëve, ndërsa eliminohet kufizimi i panevojshëm dhe diskriminues në favor të vetëm institucioneve publike.

PRETENDIMI NR. 7

1. Kërkesa e AK-së– “Pompë suvatimi – 2 copë.”

2. Dëshmia e kërkuar

AK kërkon që, nëse pajisja është në pronësi të OE-së, ajo të dëshmohet me **faturë të shoqëruar me dëshmi të transaksionit, DUD apo dokument tjetër të pronësisë**.

Nëse OE nuk e posedon pajisjen, kërkohet **marrëveshje për marrjen me qira/huazim në emër të këtij projekti, me validitet për kohëzgjatjen e kontratës, e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.**

3. Shkeljet e AK-së

Në Paramasën e Arkitekturës, pozicioni 2.1 parasheh realizimin e rreth **335 m² mure ndarëse**, ku përfshihet edhe suvatimi i të dy anëve të murit.

Nuk kontestohet se një **pompë suvatimi** mund të jetë pajisje relevante dhe e dobishme për realizimin e këtyre punimeve. Megjithatë, kontestohet kërkesa e AK-së për posedimin apo sigurimin e **dy (2) pompave të suvatimit**.

Paramasa nuk përcakton askund se suvatimi duhet të realizohet njëkohësisht në dy fronte të veçanta të punës dhe as nuk përmban ndonjë normë dinamike, afat të posaçëm apo volum të punimeve që do ta arsyetonte domosdoshmërisht nevojën për **dy pompa suvatimi në të njëjtën kohë**.

Duke marrë parasysh vëllimin prej **335 m²** të punimeve të parapara, një pompë funksionale dhe me kapacitet adekuat është e mjaftueshme për realizimin e suvatimit, ndërsa kërkesa për një pompë të dytë krijon barrë shtesë për operatorët ekonomikë pa u dëshmuar nevoja konkrete teknike për të.

AK, përmes kësaj kërkeje, nuk po verifikon vetëm nëse OE posedon kapacitetin teknik për realizimin e suvatimit, por po kërkon një **kapacitet të dyfishuar të pajisjeve**, pa e lidhur atë me sasinë, dinamikën apo afatin konkret të punimeve.

Një operator ekonomik që posedon ose siguron **një pompë profesionale suvatimi me kapacitet të mjaftueshëm** është teknikisht në gjendje të realizojë punimet e parapara. Përrjashtimi i një OE-je vetëm për shkak se nuk posedon edhe një pompë të dytë, ndonëse pajisja e parë është e mjaftueshme për realizimin e punimeve, do të ishte joproporcional me qëllimin e kriterit.

Për rrjedhojë, kërkesa për **dy (2) pompa suvatimi** është më kufizuese sesa është e nevojshme dhe nuk është e arsyetuar në raport me vëllimin konkret të punimeve.

Kjo bie ndesh me parimin e proporcionalitetit të përcaktuar në **Nenin 51 dhe Nenin 69 të LPP-së**, si dhe me kërkesën që kriteret minimale për kualifikim të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Kërkesa ndaj AK-së

Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që kërkesën “Pompë suvatimi – 2 copë” ta ndryshojë dhe ta kufizojë në vetëm një (1) pompë suvatimi.

Kriteri propozojmë të riformulohet si vijon:

“Pompë suvatimi – 1 copë.”

PRETENDIMI NR.8

Kërkesa e AK-së “Kamion kiper me kran me peshë bartëse maksimum 2 ton – 1 copë.”

Dëshmia e kërkuar

Për automjetin kërkohet **librezë valide e regjistrimit** nëse është në pronësi të OE-së, ndërsa në rast të marrjes me qira kërkohet marrëveshje në emër të projektit me validitet për kohëzgjatjen e kontratës.

Shkeljet e AK-së

Nga shqyrtimi i Paramasës së punimeve rezulton se janë paraparë demolime, demontime, largim dhe transportim të materialeve dhe mbeturinave ndërtimore. Për rrjedhojë, nuk kontestohet nevoja që Operatorit Ekonomik t'i kërkohet të ketë në dispozicion **kapacitet adekuat për transportimin dhe, sipas nevojës, manipulimin e materialeve.**

Megjithatë, Paramasa **nuk përcakton askund se ky funksion duhet të realizohet domosdoshmërisht me një “kamion kiper me kran me peshë bartëse maksimum 2 ton”.**

Në këtë mënyrë, AK nuk është kufizuar në përcaktimin e kapacitetit funksional që duhet ta posedojë OE, por ka përcaktuar një kombinim shumë specifik të karakteristikave teknike:

kamion + kiper + kran + peshë bartëse maksimum 2 ton.

Në dokumentacionin e tenderit dhe në Paramasë nuk është dhënë ndonjë arsyetim teknik se përse automjeti duhet:

- të jetë domosdoshmërisht **kiper**;
- të posedojë domosdoshmërisht **kran**;
- dhe, në veçanti, të ketë peshë bartëse **maksimum 2 ton**.

Kufizimi “maksimum 2 ton” është i paarsyetuar

Veçanërisht kufizues është përcaktimi:

“peshë bartëse maksimum 2 ton”.

AK nuk ka identifikuar ndonjë rrethanë konkrete të projektit që do ta bënte të domosdoshëm kufizimin e kapacitetit bartës në maksimum 2 ton.

Në Paramasë nuk është evidentuar:

- kufizim i kapacitetit bartës të rrugës apo sipërfaqes ku do të lëvizë automjeti;
- kufizim konstruktiv që nuk lejon automjete me kapacitet më të madh;
- kufizim të hyrjes apo dimensioneve të qasjes në objekt;
- kufizim të hapësirës së manovrimit;

- apo ndonjë arsye tjetër teknike që do ta bënte të papërshtatshëm një automjet me kapacitet më të madh se 2 ton.

Për rrjedhojë, një OE që disponon, për shembull, me një kamion kiper me kran me peshë bartëse **2.5 ton, 3 ton apo më shumë**, megjithëse automjeti mund të jetë plotësisht i aftë për realizimin e punimeve, do të konsiderohej se nuk e plotëson kriterin vetëm për shkak se kapaciteti i tij është **më i madh** se kufiri i vendosur nga AK.

Një situatë e tillë është joproporcionale, pasi **kapaciteti më i madh teknik nuk e bën automjetin më pak të aftë për realizimin e funksionit të kërkuar**.

Nëse qëllimi i AK-së është të sigurojë që OE ka në dispozicion një automjet të aftë për transportimin dhe ngritjen e materialeve, atëherë kriteri duhet të lidhet me **kapacitetin minimal funksional të nevojshëm**, dhe jo me vendosjen e një kufiri maksimal që përjashton automjete teknikisht të afta.

Kërkesa përcakton në mënyrë të panevojshme metodën e realizimit

Paramasa përcakton punët dhe rezultatin që duhet të arrihet, por nuk përcakton se ngarkimi, ngritja dhe transportimi i materialeve duhet të bëhet vetëm me këtë lloj automjeti.

Operatori Ekonomik mund të realizojë të njëjtin funksion me pajisje apo automjete të tjera teknikisht adekuate dhe ekuivalente, përderisa sigurohet realizimi i kontratës në përputhje me kërkesat teknike dhe të sigurisë.

Prandaj, kushtëzimi me një konfigurim të vetëm teknik e kufizon pa nevojë mënyrën se si OE mund ta organizojë realizimin e punimeve.

Shkelja e Nenit 7 të LPP-së

Sipas **Nenit 7 të LPP-së – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi**, Autoriteti Kontraktues duhet t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe nuk duhet të zhvillojë aktivitetin e prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën.

Kufizimi i automjetit në **maksimum 2 ton**, pa një arsyetim objektiv teknik, mund të eliminojë OE që posedojnë mjete plotësisht funksionale dhe madje me kapacitete më të larta, vetëm për shkak të një parametri formal.

Shkelja e Nenit 51 të LPP-së

Sipas **Nenit 51 të LPP-së**, kriteret e përzgjedhjes dhe dokumentet e kërkuara duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës**.

Në rastin konkret, mund të jetë relevante që OE të ketë një mjet transportues/ngritës, mirëpo **nuk është dëshmuar proporcionaliteti i kërkesës që ky mjet të ketë domosdoshmërisht peshë bartëse maksimum 2 ton**.

Qëllimi i kriterit mund të arrihet me një masë dukshëm më pak kufizuese, duke kërkuar kapacitetin funksional të nevojshëm për realizimin e punimeve.

Shkelja e Nenit 69 të LPP-së

Sipas **Nenit 69 të LPP-së**, AK mund të kërkojë dëshmi lidhur me mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që OE i ka në dispozicion për realizimin e projektit.

Megjithatë, kjo e drejtë duhet të ushtrohet në përputhje me parimin se kërkesat duhet të jenë **relevante dhe të nevojshme për realizimin e kontratës**.

Në rastin konkret, AK nuk ka dëshmuar se posedimi i një automjeti me konfigurimin e saktë **“kipër + kran + maksimum 2 ton”** është kusht teknik i domosdoshëm për realizimin e projektit.

Rregullorja për Prokurimin Publik

Edhe dispozitat e **Nenit 19 të Rregullores për Prokurimin Publik** kërkojnë që specifikimet teknike të përgatiten në mënyrë jo-diskriminuese dhe të sigurojnë qasje sa më të mirë për operatorët ekonomikë.

Kur i njëjti rezultat teknik mund të arrihet me pajisje të ndryshme, përcaktimi i një konfigurimi të vetëm, pa lejuar alternativa funksionalisht ekuivalente, e kufizon në mënyrë të panevojshme konkurrencën.

Po ashtu, kërkesat teknike duhet të jenë në përputhje me qëllimin konkret të prokurimit dhe nuk duhet të krijojnë avantazh apo pengesë të panevojshme për operatorë të caktuar ekonomikë.

Udhëzuesi për Prokurimin Publik

Edhe Udhëzuesi për Prokurimin Publik orienton AK-në që gjatë përgatitjes së Dosjes së Tenderit të shmangë kërkesat që mund të favorizojnë apo diskriminojnë operatorët ekonomikë dhe të mos krijojnë pengesa të paarsyeshme në konkurrencë.

Në rastin konkret, nevoja reale është **transportimi/ngritja e materialeve**, ndërsa kjo nevojë mund të përshkruhet përmes kërkesave funksionale pa e lidhur domosdoshmërisht me një automjet të vetëm me kapacitet maksimal të caktuar.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se kërkesa aktuale është **më kufizuese sesa është e nevojshme për vërtetimin e aftësisë teknike të OE-së** dhe nuk është e arsyetuar nga Paramasa apo natyra konkrete e punimeve.

Kërkesa ndaj AK-së

Për arsyet e lartcekura, **kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta largojë kriterin në formën aktuale:**

“Kamion kiper me kran me peshë bartëse maksimum 2 ton – 1 copë.”

PRETENDIMI NR.9

Kërkesa e AK-së “Kamionetë dubël kabinë kiper – 1 copë.”

Dëshmia e kërkuar

Kërkohet librezë valide e regjistrimit ose, në rast të qirasë, marrëveshje valide në emër të projektit për tërë kohëzgjatjen e kontratës.

Shkeljet e AK-së

ga shqyrtimi i Paramasës së punimeve nuk rezulton ndonjë pozicion që kërkon në mënyrë të drejtpërdrejtë përdorimin e një automjeti me konfigurimin specifik:

“kamionetë + dubël kabinë + kiper”.

Nuk kontestohet se gjatë realizimit të kontratës Operatorit Ekonomik mund t'i nevojiten mjete transportuese për bartjen e materialeve, veglave, pajisjeve apo mbeturinave.

Megjithatë, kjo nevojë e përgjithshme për transport **nuk e arsyeton automatikisht kërkesën që OE të posedojë ose të sigurojë pikërisht një kamionetë dubël kabinë kiper.**

Nuk është arsyetuar nevoja për “dubël kabinë”

Paramasa nuk përcakton:

- numrin e personave që duhet të transportohen me këtë automjet;
- nevojën që personeli dhe materialet të transportohen në mënyrë të njëkohshme me të njëjtin mjet;
- ndonjë pozicion të punimeve ku kërkohet posaçërisht automjet me kabinë të dyfishtë;
- ndonjë karakteristikë të kantierit që do ta bënte të domosdoshme pikërisht “dubël kabinën”.

Pra, karakteristika **“dubël kabinë”** nuk lidhet me ndonjë kapacitet teknik të identifikuar në Paramasë.

Një operator mund të organizojë transportin e personelit dhe materialeve në mënyra të ndryshme dhe me automjete të ndryshme, për sa kohë realizimi i kontratës bëhet në mënyrë të rregullt dhe të sigurt.

Për këtë arsye, AK nuk duhet ta kushtëzojë kualifikimin e OE-së me posedimin e një konfigurimi të caktuar të kabinës së automjetit pa dëshmuar nevojën teknike për të.

Nuk është arsyetuar nevoja që kamioneta të jetë “kiper”

Edhe elementi i dytë i kërkesës, përkatësisht që kamioneta të jetë **“kiper”**, nuk është lidhur nga AK me ndonjë pozicion konkret të Paramasës.

Paramasa parasheh largim dhe transportim të materialeve dhe mbeturinave, mirëpo nuk përcakton që këto punë mund të kryhen vetëm përmes një **kamionete të vogël vetëshkarkuese**.

OE mund të sigurojë kapacitetin e nevojshëm transportues edhe me mjete të tjera transportuese që janë të përshtatshme për natyrën dhe vëllimin e materialeve.

Për rrjedhojë, qëllimi legjitim i AK-së duhet të jetë të vërtetojë se operatori ka **kapacitet të mjaftueshëm për transport**, dhe jo që operatori posedon pikërisht një automjet me konfigurimin “dubël kabinë kiper”.

Kërkesa përcakton formën e automjetit dhe jo aftësinë reale teknike

Problemi kryesor me këtë kriter është se ai nuk është formuluar sipas **funksionit që duhet të realizohet**, por sipas konfigurimit fizik të automjetit.

Një Operator Ekonomik mund të ketë në dispozicion automjete transportuese që teknikisht janë plotësisht të afta për realizimin e punimeve, por të mos posedojë pikërisht një **kamionetë dubël kabinë kiper**.

Në një situatë të tillë, OE mund të eliminohet jo për shkak të mungesës së kapacitetit teknik për realizimin e kontratës, por vetëm për shkak se automjeti i tij nuk përputhet me konfigurimin formal të kërkuar nga AK.

Kjo e zhvendos vlerësimin nga **aftësia reale teknike** të posedimi i një lloji specifik automjeti.

Shkelja e Nenit 7 të LPP-së

Sipas **Nenit 7 të LPP-së**, Autoriteti Kontraktues duhet t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe nuk duhet të zhvillojë aktivitetin e prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën.

Kushtëzimi me një automjet me konfigurim kaq specifik, pa u dëshmuar domosdoshmëria e tij teknike, mund të reduktojë numrin e operatorëve ekonomikë që mund ta plotësojnë kriterin, edhe pse ata mund të posedojnë mjete të tjera transportuese plotësisht të përshtatshme për realizimin e punimeve.

Shkelja e Nenit 51 të LPP-së

Sipas **Nenit 51 të LPP-së**, kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen në ato që janë të nevojshme për të vërtetuar aftësinë profesionale dhe teknike të operatorit ekonomik dhe duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës.

Në rastin konkret, mund të jetë relevante që OE të ketë kapacitet transportues, mirëpo nuk është dëshmuar se për këtë qëllim është i nevojshëm pikërisht konfigurimi:

“kamionetë dubël kabinë kiper”.

Qëllimi mund të arrihet me një kërkesë dukshëm më pak kufizuese, të formuluar sipas funksionit të transportit dhe jo sipas llojit konkret të automjetit.

Shkelja e Nenit 69 të LPP-së

Neni 69 i LPP-së i mundëson AK-së të kërkojë dëshmi lidhur me mjetet dhe pajisjet teknike që OE i ka në dispozicion për realizimin e kontratës.

Megjithatë, kërkimi i këtyre pajisjeve duhet të lidhet me **nevojën reale për realizimin e projektit** dhe nuk nënkupton se AK mund të përcaktojë çdo lloj automjeti pa lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetet konkrete të kontratës.

Në rastin konkret, nuk është paraqitur ndonjë pozicion i Paramasës që e bën të domosdoshëm pikërisht këtë konfigurim të automjetit.

Shkelja e Nenit 25.17 të Rregullores për Prokurimin Publik

Neni 25.17 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, në versionin e konsoliduar me ndryshimet e Rregullores Nr. 002/2024, përcakton shprehimisht se:

“Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.”

Kërkesa për një **kamionetë dubël kabinë kiper**, pa identifikuar se cili pozicion konkret i kontratës e kërkon këtë konfigurim, nuk e plotëson në mënyrë të mjaftueshme kriterin e relevancës dhe proporcionalitetit.

Shkelja e Nenit 25.18 të Rregullores

Neni 25.18 obligon AK-në që kërkesat minimale për kualifikim t'i formulojë në mënyrë që të mos përjashtohen operatorët ekonomikë që posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike.

Një OE që posedon mjete të tjera transportuese adekuate mund të ketë plotësisht aftësinë teknike për realizimin e kontratës, por të eliminohet vetëm për shkak se nuk posedon konfigurimin specifik “dubël kabinë kiper”.

Neni 19.15 i Rregullores – zgjidhjet ekuivalente teknike

Neni 19.15(d) i Rregullores kërkon që, kur përshkruhen teknikat ndërtuese dhe pajisjet që do të përdoren, të jepet indikacion edhe për **alternativat e mundshme dhe zgjidhjet ekuivalente teknike**, duke iu referuar Projektit Ekzekutues.

Në rastin konkret, AK ka përcaktuar një lloj të vetëm automjeti, pa paraparë mundësinë që i njëjti funksion të realizohet me një mjet tjetër transportues ekuivalent.

Neni 19.16 i Rregullores

Sipas **Nenit 19.16**, specifikimet teknike duhet të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit, të drejtohen drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për operatorët ekonomikë dhe të përgatiten në mënyrë që të mos favorizojnë apo diskriminojnë operatorë të caktuar.

Në këtë rast, nëse qëllimi është sigurimi i kapacitetit transportues, atëherë kërkesa duhet të përshkruajë **kapacitetin/funksionin e kërkuar**, dhe jo të imponojë domosdoshmërisht një konfigurim të vetëm të automjetit.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se kërkesa **“Kamionetë dubël kabinë kiper – 1 copë”** është më specifike dhe më kufizuese sesa është e nevojshme për vërtetimin e aftësisë teknike të OE-së.

Kërkesa ndaj AK-së

Për arsyet e lartcekura, **kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta largojë në tërësi nga lista e pajisjeve minimale kërkesën:**

“Kamionetë dubël kabinë kiper – 1 copë.”

PRETENDIMI NR.10

Kërkesa e AK-së

“Kamionetë dubël kabinë me vinç, peshë ngarkuese min. 800 kg – 1 copë.”

Dëshmia e kërkuar

Për automjetin kërkohet **librezë valide e regjistrimit**, në rast se është në pronësi të Operatorit Ekonomik.

Në rast se OE nuk e posedon automjetin në pronësi, kërkohet **marrëveshje valide për marrjen me qira/huazim në emër të këtij projekti, me validitet për tërë kohëzgjatjen e kontratës, e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.**

Shkeljet e AK-së

Nga shqyrtimi i Paramasës rezulton se kontrata përfshin furnizim, transport dhe montim të materialeve dhe pajisjeve të ndryshme. Për rrjedhojë, nuk kontestohet se gjatë realizimit të kontratës mund të paraqitet nevoja për **ngritje, bartje apo manipulim të materialeve.**

Megjithatë, Paramasa **nuk përcakton askund që këto operacione duhet të realizohen domosdoshmërisht me një kamionetë dubël kabinë të pajisur me vinç dhe me peshë ngarkuese minimum 800 kg.**

Pra, AK nuk është kufizuar në përcaktimin e funksionit që duhet të realizohet, por ka përcaktuar një konfigurim të caktuar të automjetit:

kamionetë + dubël kabinë + vinç + kapacitet minimum 800 kg.

Nuk është arsyetuar nevoja për “dubël kabinë”

Paramasa nuk përcakton se personeli duhet të transportohet së bashku me materialet përmes të njëjtit automjet.

Nuk përcakton as:

- numrin e personave që duhet të transportohen;
- nevojën për një automjet me dy rreshta ulësesh;
- ndonjë pozicion pune që e bën të domosdoshme kabinën e dyfishtë;
- ndonjë karakteristikë të kantierit që e lidh realizimin e punimeve me një automjet “dubël kabinë”.

Për këtë arsye, karakteristika **“dubël kabinë”** nuk është e lidhur me ndonjë aftësi teknike që duhet të dëshmohet për realizimin e kontratës.

Një OE mund të posedojë kapacitet të plotë për ngritjen dhe transportimin e materialeve me automjete apo pajisje të tjera, edhe nëse ato nuk janë të tipit “dubël kabinë”.

Nuk është arsyetuar që vinçi duhet të jetë i integruar në kamionetë

Nëse qëllimi i AK-së është të sigurojë kapacitet për ngritjen dhe manipulimin e materialeve, ky funksion mund të realizohet me pajisje të ndryshme profesionale, për shembull:

- kamion me kran;
- autokran;
- vinç mobil;
- forklift;
- pajisje hidraulike ngritëse;
- pajisje tjetër ekuivalente.

Paramasa nuk përcakton se funksioni i ngritjes mund të realizohet vetëm përmes një **vinçi të montuar në kamionetë dubël kabinë**.

Prandaj, kërkesa në formën aktuale kufizon metodën e organizimit të punimeve të OE-së, edhe pse i njëjti rezultat teknik mund të arrihet me pajisje të tjera të përshtatshme.

Parametri “minimum 800 kg” nuk është i mbështetur me përlllogaritje konkrete

AK ka përcaktuar edhe kërkesën:

“peshë ngarkuese min. 800 kg”.

Megjithatë, në Paramasë nuk është identifikuar:

- një pajisje konkrete me peshë 800 kg që duhet të ngrihet;
- një element konstruktiv apo makinerik që kërkon kapacitet ngritës pikërisht 800 kg;
- një ngarkesë minimale të përlllogaritur;

- apo ndonjë analizë teknike që e bën këtë kapacitet kufi të domosdoshëm.

Nëse AK ka nevojë për një kapacitet minimal ngritës, ai duhet të jetë i lidhur me **peshën reale të elementeve që do të manipulohen** dhe jo të vendoset pa një përlllogaritje të identifikueshme në dokumentacionin e tenderit.

Kërkesa mat posedimin e një konfigurimi të caktuar dhe jo aftësinë reale të OE-së

Një Operator Ekonomik mund të posedojë, për shembull, një kamion me kran me kapacitet më të madh, një autokran apo një pajisje tjetër ngritëse që është plotësisht e aftë për realizimin e punimeve, por megjithatë të mos e plotësojë kriterin vetëm sepse nuk posedon:

“kamionetë dubël kabinë me vinç”.

Në këtë mënyrë, kriteri nuk vlerëson nëse OE ka kapacitet për **ngritjen dhe manipulimin e materialeve**, por nëse posedon pikërisht një lloj të caktuar automjeti.

Kjo qasje mund të eliminojë operatorë teknikisht të aftë për arsye thjesht formale.

Shkelja e Nenit 7 të LPP-së

Sipas **Nenit 7 të LPP-së**, Autoriteti Kontraktues duhet t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe nuk duhet të zhvillojë aktivitetin e prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën.

Në rastin konkret, kërkesa për një konfigurim shumë specifik të automjetit, pa u dëshmuar domosdoshmëria e secilës karakteristikë të tij, mund të përjashtojë operatorë që posedojnë pajisje të tjera teknikisht të barasvlershme ose më të afta.

Shkelja e Nenit 51 të LPP-së

Sipas **Nenit 51 të LPP-së**, kriteret e përzgjedhjes duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës**.

Në rastin konkret, mund të jetë relevante që OE të ketë kapacitet ngritës, mirëpo nuk është dëshmuar se është e nevojshme që ai kapacitet të sigurohet pikërisht përmes:

“kamionetës dubël kabinë me vinç, minimum 800 kg”.

Një kërkesë funksionale për pajisje ngritëse me kapacitet adekuat do ta arrinte të njëjtin qëllim me një masë dukshëm më pak kufizuese.

Shkelja e Nenit 69 të LPP-së

Neni 69 i LPP-së i lejon AK-së të kërkojë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që OE i ka në dispozicion për realizimin e projektit.

Megjithatë, kërkesa duhet të lidhet me **kapacitetet reale që janë relevante dhe të nevojshme për realizimin e punimeve.**

Në rastin konkret, AK nuk ka identifikuar pozicion konkret të Paramasës që kërkon posedimin e një kamionete dubël kabinë me vinç dhe nuk ka arsyetuar pse një pajisje tjetër ngritëse ekuivalente nuk mund ta realizojë të njëjtin funksion.

Shkelja e proporcionalitetit dhe kufizimi i zgjidhjeve ekuivalente

Kur qëllimi teknik është ngritja dhe manipulimi i materialeve, kriteri duhet të orientohet drejt **funksionit dhe kapacitetit real të nevojshëm**, duke lejuar zgjidhje ekuivalente.

Kërkesa aktuale, duke imponuar në mënyrë kumulative llojin e automjetit, konfigurimin e kabinës, praninë e vinçit dhe kapacitetin minimal, është më e ngushtë sesa është e nevojshme për arritjen e qëllimit të prokurimit.

Në këtë kuptim, kriteri mund të ketë efekt kufizues mbi konkurrencën pa ofruar ndonjë avantazh të dëshmuar teknik për realizimin e kontratës.

Kërkesa ndaj AK-së

Për arsye të lartcekura, **kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta largojë nga lista e pajisjeve minimale kërkesën:**

“Kamionetë dubël kabinë me vinç, peshë ngarkuese min. 800 kg – 1 copë.”

PRETENDIMI NR.11

Kërkesa e AK-së

“Pajisje për lokalizimin e instalimeve nëntokësore të rrymës me pjesë përcjellëse – 1 copë.”

Dëshmia e kërkuar

Për pajisjen që nuk i nënshtrohet regjistrimit, Autoriteti Kontraktues kërkon që OE ta dëshmojë posedimin përmes **faturës së shoqëruar me dëshmi të transaksionit, DUD-it apo dokumentit tjetër përkatës të pronësisë.**

Në rast se OE nuk e posedon pajisjen në pronësi, kërkohet **marrëveshje për marrjen me qira/huazim në emër të këtij projekti, me validitet për tërë kohëzgjatjen e kontratës, e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.**

Shkeljet e AK-së

Nga shqyrtimi i **Paramasës së Elektroinstalimeve** rezulton se punimet elektrike të parapara për këtë kontratë janë punime që realizohen kryesisht **brenda objektit, në përdhese dhe në katin e parë.**

Paramasa përmban, ndër të tjera, furnizim dhe montim të:

- tabelave shpërndarëse;
- ndërprerësve dhe pajisjeve mbrojtëse;
- ndriçimit LED;
- prizave dhe çelësve;
- kablllove elektrike;
- kablllove të rrjetit dhe TV-së;
- sistemit të alarmit të zjarrit;
- ventilatorëve;
- tubave PVC/halogen-free për instalimet elektrike;
- kutive montuese dhe lidhëse;
- elementeve të barazimit potencial dhe tokëzimit.

Megjithatë, nga Paramasa **nuk rezulton asnjë pozicion konkret që parasheh punime në rrjet elektrik nëntokësor.**

Në veçanti, nuk është identifikuar pozicion për:

- **gërmime për instalime elektrike nëntokësore;**
- **hapje të kanaleve apo traseve në tokë për kablllo elektrike;**
- **lokalizim të kablllove ekzistuese nëntokësore;**
- **identifikim apo hartëzim të rrjeteve elektrike nëntokësore;**
- **zhvendosje të instalimeve elektrike nëntokësore;**
- **vendosje të kablllove të reja nëntokësore;**
- **punime në rrjet elektrik të jashtëm që kërkojnë lokalizim paraprak të instalimeve të fshehura në tokë.**

Për rrjedhojë, **nuk ekziston në Paramasë një aktivitet konkret me të cilin mund të lidhet domosdoshmëria e pajisjes së kërkuar.**

Pajisja e kërkuar nuk lidhet me natyrën e punimeve elektrike të parashikuara

Pajisja për lokalizimin e instalimeve nëntokësore të rrymës është pajisje me funksion specifik: përdoret për identifikimin/lokalizimin e kablllove apo instalimeve që ndodhen nën tokë ose në trase të fshehura.

Mirëpo, punimet elektrike të përshkruara në Paramasë janë kryesisht punime të instalimeve të brendshme të objektit.

Për shembull, edhe tubat PVC të paraparë në Paramasë, me diametra Ø20 mm, Ø25 mm dhe Ø32 mm, janë përshkruar për **instalimet elektrike, feederët dhe grupet e prizave**, dhe jo si instalime të një infrastrukture elektrike nëntokësore të jashtme.

Prandaj, ekzistenca e kablllove dhe tubave elektrikë në Paramasë **nuk mund të përdoret automatikisht si arsyetim për kërkesën për pajisje të lokalizimit të instalimeve nëntokësore**, përderisa vetë Paramasa nuk parasheh punime që kërkojnë zbulimin apo lokalizimin e një rrjeti të tillë.

AK ka kërkuar një pajisje të specializuar pa identifikuar punën për të cilën nevojitet

Kriteret për pajisjet teknike duhet të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me punët që OE do të realizojë.

Në rastin konkret, AK ka kërkuar që OE, që në fazën e tenderimit, të dëshmojë pronësinë ose të sigurojë marrëveshje qiraje për një pajisje të specializuar, por **nuk ka identifikuar se në cilin pozicion të Paramasës do të përdoret ajo pajisje.**

Kjo do të thotë se një OE mund të posedojë të gjithë personelin, pajisjet dhe kapacitetet reale të nevojshme për realizimin e instalimeve elektrike të projektuara dhe megjithatë të eliminohet vetëm për shkak se nuk posedon apo nuk ka marrë me qira një pajisje për lokalizimin e instalimeve nëntokësore, edhe pse punime të tilla nuk janë të evidentuara në Paramasë.

Në këtë mënyrë, kriteri nuk është duke matur **aftësinë reale të OE-së për realizimin e kontratës**, por posedimin formal të një pajisjeje për të cilën nuk është dëshmuar nevoja konkrete.

Kërkesa krijon barrë të panevojshme për OE-të

Kërkesa bëhet edhe më kufizuese për faktin se AK nuk e ka përcaktuar pajisjen thjesht si mjet që kontraktuesi duhet ta sigurojë **nëse gjatë realizimit paraqitet nevoja**, por e ka vendosur si kriter minimal që duhet të dëshmohet paraprakisht me:

- faturë dhe dëshmi transaksioni;
- DUD;
- dokument pronësie;
- ose marrëveshje qiraje/huazimi me validitet për tërë kohëzgjatjen e kontratës.

Kjo i detyron operatorët ekonomikë që nuk e posedojnë një pajisje të tillë të lidhin marrëveshje qiraje për tërë kohëzgjatjen e kontratës, **edhe pse dokumentacioni teknik nuk tregon se pajisja do të përdoret në realizimin e ndonjë pozicioni konkret.**

Një barrë e tillë nuk është proporcionale me qëllimin e vërtetimit të aftësisë teknike.

Shkelja e Nenit 7 të LPP-së

Sipas **Nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik**, Autoriteti Kontraktues duhet t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe nuk duhet ta zhvillojë aktivitetin e prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën.

Vendosja e një pajisjeje të specializuar si kriter minimal, kur për të nuk rezulton një punë përkatëse në Paramasë, mund të përjashtojë operatorë ekonomikë që posedojnë kapacitet të plotë për realizimin e kontratës, vetëm për shkak të mungesës së një pajisjeje që nuk është dëshmuar si e nevojshme.

Kjo krijon një kufizim të konkurrencës që nuk lidhet me aftësinë reale teknike të operatorëve.

Shkelja e Nenit 51 të LPP-së

Neni 51 i LPP-së kërkon që kriteret e përzgjedhjes të kufizohen në ato që janë të nevojshme për të vërtetuar aftësitë profesionale dhe teknike të operatorit ekonomik dhe që kriteret dhe dokumentet e kërkuara të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës**.

Në rastin konkret, nuk është dëshmuar relevanca e drejtpërdrejtë ndërmjet:

“Pajisjes për lokalizimin e instalimeve nëntokësore të rrymës”

dhe punimeve konkrete të Elektroinstalimeve të përshkruara në Paramasë.

Përderisa Paramasa nuk përmban punime për lokalizim, germim, zhvendosje apo ndërtim të rrjetit elektrik nëntokësor, kërkesa për këtë pajisje tejkalon atë që është e nevojshme për vërtetimin e aftësisë teknike.

Shkelja e Nenit 69 të LPP-së

Neni 69 i LPP-së i mundëson Autoritetit Kontraktues të kërkojë dëshmi lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional, përfshirë pajisjet dhe mjetet që OE ka në dispozicion për realizimin e projektit. Megjithatë, këto kërkesa duhet të lidhen me kapacitetet që janë relevante dhe të nevojshme për realizimin e kontratës.

Kjo dispozitë nuk duhet interpretuar si autorizim për të kërkuar çdo pajisje që potencialisht mund të përdoret në fushën e ndërtimit apo elektroinstalimeve.

Duhet të ekzistojë një **lidhje objektive ndërmjet pajisjes së kërkuar dhe punimeve konkrete të kontratës**.

Në këtë rast një lidhje e tillë nuk rezulton nga Paramasa.

Shkelja e parimit të proporcionalitetit sipas Rregullores për Prokurimin Publik

Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, në versionin e konsoliduar me ndryshimet e Rregullores Nr. 002/2024, kërkon që kërkesat minimale për kualifikim të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës**.

Në rastin konkret, kërkesa nuk është proporcionale sepse OE-së i kërkohet të dëshmojë posedimin ose sigurimin me qira të një pajisjeje të specializuar, ndërkohë që në Paramasë nuk ekziston pozicion që e bën përdorimin e saj të domosdoshëm.

Një kriter proporcional do të kërkonte vetëm pajisjet që kanë lidhje të identifikueshme me natyrën dhe vëllimin e punimeve që do të realizohen.

Mungesa e arsytimit teknik

Nëse Autoriteti Kontraktues konsideron se, pavarësisht mungesës së një pozicioni të veçantë në Paramasë, ekziston një rrjet elektrik nëntokësor që duhet të lokalizohet gjatë realizimit të projektit, atëherë një fakt i tillë duhet të rezultojë nga:

- Projekti Ekzekutues;
- situacioni ekzistues i instalimeve;
- planet e rrjeteve;
- përshkrimi teknik;
- ose një pozicion konkret i Paramasës.

Në dokumentacionin e analizuar nuk rezulton një aktivitet i tillë.

Për këtë arsye, **barra për të arsyetuar nevojën teknike të kësaj pajisjeje i takon AK-së**, pasi ajo është pala që e ka vendosur si kriter minimal detyrues.

Kërkesa ndaj AK-së

Për arsyet e lartcekura, **kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta largojë në tërësi nga lista e pajisjeve minimale kërkesën:**

“Pajisje për lokalizimin e instalimeve nëntokësore të rrymës me pjesë përcjellëse – 1 copë.”

PRETENDIMI NR.12

Kërkesa e AK-së “Pajisje për detektimin e drurit prapa sipërfaqeve – 1 copë.”

Dëshmia e kërkuar

Për pajisjen që nuk i nënshtrohet regjistrimit, Autoriteti Kontraktues kërkon që OE ta dëshmojë posedimin përmes **faturës së shoqëruar me dëshmi të transaksionit, DUD-it apo dokumentit tjetër përkatës të pronësisë.**

Në rast se OE nuk e posedon pajisjen në pronësi, kërkohet **marrëveshje për marrjen me qira/huazim në emër të këtij projekti, me validitet për tërë kohëzgjatjen e kontratës, e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.**

Shkeljet e AK-së

Nga shqyrtimi i Paramasës së punimeve nuk rezulton ndonjë pozicion që parasheh **diagnostikim, skanim apo lokalizim të elementeve prej druri të fshehura prapa mureve, plafoneve apo sipërfaqeve të tjera**, për të cilat do të ishte e domosdoshme përdorimi i një pajisjeje të posaçme për detektimin e drurit.

Kërkesa e AK-së për këtë pajisje është veçanërisht e paarsyetuar në raport me punimet e kulmit.

Punimet e kulmit nuk e arsyetojnë këtë pajisje

Në Paramasë janë paraparë punime të renovimit të kulmit, përfshirë ndërhyrje në shtresat ekzistuese dhe kontrollimin/zëvendësimin sipas nevojës të elementeve prej druri, si listelat dhe kundërlistelat.

Mirëpo, këto elemente kontrollohen gjatë procesit të hapjes së kulmit, përkatësisht **pas çmontimit të tjegullave dhe shtresave që i mbulojnë ato.**

Në atë fazë, elementet prej druri bëhen **fizikisht të ekspozuara dhe të qasshme për kontroll vizual dhe teknik.**

Për rrjedhojë, nuk ekziston nevoja që listelat, kundërlistelat apo elementet e tjera të drurit të lokalizohen përmes një pajisjeje elektronike për detektim prapa sipërfaqeve.

Pra, vetë mënyra e realizimit të punimeve të parashikuara në Paramasë e bën këtë pajisje të panevojshme.

Paramasa nuk përmban punime për lokalizimin e elementeve të fshehura prej druri

Në asnjë pozicion të Paramasës nuk është kërkuar:

- skanim i mureve për elemente druri;
- lokalizim i konstruksioneve të fshehura prej druri;
- identifikim i trarëve të fshehur pa hapje të sipërfaqes;
- diagnostikim jo-destruktiv i strukturave prej druri;
- hartëzim i elementeve të drurit prapa sipërfaqeve;
- apo ndonjë aktivitet tjetër që kërkon domosdoshmërisht pajisje të posaçme detektimi.

Për rrjedhojë, AK nuk ka identifikuar **asnjë pozicion konkret të Paramasës** ku kjo pajisje do të ishte e nevojshme për realizimin e punëve.

Pajisja mund të jetë ndihmëse, por jo kriter minimal për kualifikim

Nuk përjashtohet mundësia që një pajisje për detektimin e drurit të jetë një mjet ndihmës që një kontraktues mund ta përdorë në raste të caktuara gjatë realizimit të punimeve.

Megjithatë, ekziston dallim thelbësor ndërmjet:

një mjeti që mund të jetë i dobishëm në raste të caktuara

dhe

një pajisjeje që është aq e domosdoshme për realizimin e kontratës sa që duhet të vendoset si kriter minimal për kualifikimin e operatorëve ekonomikë.

Në rastin konkret, Paramasa nuk e mbështet përfundimin se kjo pajisje është e domosdoshme.

Përkundrazi, për pjesën kryesore ku paraqiten elemente druri – punimet e kulmit – elementet ekspozohen gjatë procesit normal të çmontimit dhe kontrollohen drejtpërdrejt.

AK po e shndërron një vegël ndihmëse në kriter eliminues

Problemi bëhet edhe më i theksuar për faktin se AK nuk ka kërkuar thjesht që kontraktuesi ta sigurojë këtë pajisje **nëse paraqitet nevoja gjatë ekzekutimit**, por ka kërkuar që OE që në fazën e tenderimit të dëshmojë:

- pronësinë e pajisjes; ose
- marrëveshjen e qirasë/huazimit për këtë projekt.

Kjo do të thotë se një OE që posedon të gjithë kapacitetin profesional, teknik dhe material të nevojshëm për realizimin e kontratës mund të eliminohet vetëm për shkak se nuk posedon një pajisje për detektimin e drurit, edhe pse **nuk ekziston pozicion në Paramasë që e kërkon përdorimin e saj**.

Në këtë mënyrë, një vegël potencialisht ndihmëse shndërrohet në një **kusht formal eliminues**, pa qenë e dëshmuar domosdoshmëria e saj.

Shkelja e Nenit 7 të LPP-së

Sipas **Nenit 7 të LPP-së**, Autoriteti Kontraktues është i obliguar t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe nuk duhet të zhvillojë aktivitetin e prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën.

Vendosja si kriter minimal e një pajisjeje për të cilën nuk ekziston aktivitet përkatës në Paramasë mund të rezultojë në eliminimin e operatorëve ekonomikë që posedojnë aftësinë reale për realizimin e kontratës, vetëm për shkak të mungesës së një mjeti që nuk është dëshmuar si i domosdoshëm.

Një kufizim i tillë nuk lidhet me aftësinë reale teknike të operatorit, por me posedimin formal të një pajisjeje të caktuar.

Shkelja e Nenit 51 të LPP-së

Sipas **Nenit 51 të LPP-së**, kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në ato që janë të nevojshme për të vërtetuar kapacitetin profesional dhe teknik të operatorit ekonomik, ndërsa kriteret dhe dokumentet e kërkuara duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës**.

Në rastin konkret nuk është dëshmuar lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet:

“Pajisjes për detektimin e drurit prapa sipërfaqeve”

dhe ndonjë pozicioni konkret të Paramasës.

Për këtë arsye, kërkesa nuk e kalon testin e relevancës dhe proporcionalitetit.

Shkelja e Nenit 69 të LPP-së

Neni 69 i LPP-së i mundëson Autoritetit Kontraktues të kërkojë dëshmi lidhur me mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që OE i ka në dispozicion për realizimin e projektit.

Megjithatë, kjo e drejtë nuk nënkupton se AK mund të kërkojë çdo pajisje që potencialisht mund të përdoret në një aktivitet ndërtimor.

Pajisja duhet të jetë relevante dhe e nevojshme për realizimin e punimeve konkrete të kontratës.

Në rastin konkret, Paramasa nuk përmban punime që kërkojnë lokalizimin e drurit të fshehur, ndërsa elementet prej druri në kulm bëhen të qasshme gjatë çmontimit të shtresave ekzistuese.

Prandaj, kërkesa nuk është e mbështetur me nevojë konkrete teknike.

Shkelja e parimit të proporcionalitetit sipas Rregullores për Prokurimin Publik

Sipas Rregullores për Prokurimin Publik, kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.**

Në këtë rast, Operatorit Ekonomik i kërkohet të dëshmojë pronësinë apo sigurimin me qira të një pajisjeje të specializuar, ndërkohë që nuk ekziston një pozicion konkret ku përdorimi i saj është i domosdoshëm.

Kjo krijon një barrë më të madhe sesa është e nevojshme për verifikimin e aftësisë teknike dhe mund të kufizojë në mënyrë të panevojshme konkurrencën.

AK duhet të dëshmojë domosdoshmërinë e pajisjes

Nëse Autoriteti Kontraktues konsideron se, pavarësisht përmbajtjes së Paramasës, ekzistojnë elemente të fshehura prej druri që duhet të lokalizohen përpara fillimit të punimeve, atëherë duhet të tregojë konkretisht:

- ku ndodhen këto elemente;
- në cilën pjesë të objektit;
- për cilin pozicion të Paramasës duhet të lokalizohen;
- pse nuk mund të evidentohen gjatë procesit normal të çmontimit;
- dhe pse përdorimi i një pajisjeje të posaçme detektimi është teknikisht i domosdoshëm.

Në mungesë të një arsyeimi të tillë, kërkesa mbetet e pambështetur në dokumentacionin teknik të tenderit.

Kërkesa ndaj AK-së

Për arsyet e lartcekura, **kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta largojë në tërësi nga lista e pajisjeve minimale kërkesën:**

“Pajisje për detektimin e drurit prapa sipërfaqeve – 1 copë.”

PRETENDIMI NR.13

Kërkesa e AK-së “Pajisje për detektimin e metaleve në sipërfaqe të ndryshme – 1 copë.”

Dëshmia e kërkuar

Për pajisjen që nuk i nënshtrohet regjistrimit, Autoriteti Kontraktues kërkon që OE ta dëshmojë posedimin përmes **faturës së shoqëruar me dëshmi të transaksionit, DUD-it apo dokumentit tjetër përkatës të pronësisë.**

Në rast se OE nuk e posedon pajisjen në pronësi, kërkohet **marrëveshje për marrjen me qira/huazim në emër të këtij projekti, me validitet për tërë kohëzgjatjen e kontratës, e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.**

Shkeljet e AK-së

Nga shqyrtimi i Paramasës së punimeve nuk rezulton ndonjë pozicion që kërkon në mënyrë të drejtpërdrejtë përdorimin e një **pajisjeje për detektimin e metaleve në sipërfaqe të ndryshme.**

Në veçanti, Paramasa nuk përmban ndonjë pozicion për:

- **skanim të armaturës së betonit;**
- **lokalizim të shufrave të armaturës para shpimit apo prerjes;**
- **hartëzim të armaturës së konstruksionit;**
- **kontroll jo-destruktiv të elementeve të betonit;**
- **lokalizim sistematik të elementeve metalike të fshehura prapa mureve apo dysHEMEVE;**
- **diagnostikim të konstruksionit ekzistues me pajisje elektronike;**
- **inspektim të betonit të armuar që kërkon përcaktimin e pozicionit apo thellësisë së armaturës.**

Paramasa përmban disa punime ku përdoren elemente metalike, si fiksime, bulona, ankerat, shkallë metalike, ulluqe dhe konstruksione të tjera ndihmëse, mirëpo këto punime **nuk janë të njëjta me detektimin e metaleve të fshehura në sipërfaqe.**

Vetë fakti që në një kontratë ndërtimore përdoren elemente metalike nuk e bën automatikisht të domosdoshme një pajisje të specializuar për detektimin e metaleve.

Paramasa përmban punime ankorimi dhe fiksimi, por nuk kërkon skanim të armaturës

Nga Paramasa rezulton se në disa pozicione parashihen ankerat, bulona dhe elemente fiksimi, për shembull gjatë realizimit të instalimeve makinerike apo montimit të elementeve të caktuara.

Megjithatë, në asnjë prej këtyre pozicioneve nuk përcaktohet që para realizimit të fiksimeve duhet të kryhet **skanim i sipërfaqeve për lokalizimin e metaleve apo armaturës së fshehur.**

Po ashtu, nuk është përcaktuar:

- lloji i konstruksionit që duhet skanuar;
- sipërfaqja që duhet kontrolluar;
- numri i pikave ku kërkohet detektimi;
- thellësia e kërkuar e skanimit;
- saktësia e pajisjes;
- apo ndonjë metodologji diagnostikuese për të cilën kjo pajisje është e domosdoshme.

Për rrjedhojë, ekzistenca e punimeve të montimit apo ankorimit **nuk është e mjaftueshme për ta shndërruar detektorin e metaleve në kriter minimal për kualifikim.**

Pajisja mund të jetë mjet ndihmës, por nuk është dëshmuar si kapacitet minimal i domosdoshëm

Një pajisje për detektimin e metaleve mund të jetë e dobishme në raste të caktuara, për shembull gjatë një shpimi në një element ekzistues ku kontraktuesi dëshiron të kontrollojë paraprakisht nëse ekziston armaturë apo instalim metalik.

Mirëpo, kjo është një çështje tjetër nga ajo nëse një pajisje e tillë duhet të jetë **kriter minimal eliminues në fazën e tenderimit.**

Kërkesat minimale për kualifikim duhet të vërtetojnë se OE posedon **kapacitetet thelbësore dhe të nevojshme për realizimin e kontratës**, dhe jo që ai posedon çdo vegël ndihmëse që potencialisht mund të jetë e dobishme gjatë ndonjë operacioni të veçantë.

Në rastin konkret, AK nuk ka identifikuar ndonjë aktivitet të Paramasës për të cilin realizimi i kontratës do të ishte i pamundur pa këtë pajisje.

Formulimi “në sipërfaqe të ndryshme” është gjithashtu i paqartë

AK e ka formuluar kërkesën:

“Pajisje për detektimin e metaleve në sipërfaqe të ndryshme”.

Ky formulim është i përgjithshëm dhe nuk përcakton as karakteristikat minimale funksionale të pajisjes.

Nuk është e qartë nëse AK kërkon pajisje për:

- detektim të armaturës në beton;
- detektim të profileve metalike prapa gipsit;
- detektim të tubacioneve;
- skanim të dysHEMEVE;
- lokalizim të metaleve në muraturë;
- apo një lloj tjetër të pajisjes diagnostikuese.

Pajisjet e detektimit ndryshojnë dukshëm sipas funksionit, thellësisë së detektimit dhe materialit që kontrollohet.

Për rrjedhojë, kriteri është jo vetëm i panevojshëm në raport me Paramasën, por edhe i **paqartë për sa i përket pajisjes konkrete që OE duhet të dëshmojë.**

Kjo krijon rrezik që operatorë të ndryshëm të paraqesin pajisje të ndryshme dhe që në fazën e vlerësimit AK të vendosë sipas një interpretimi që nuk është përcaktuar paraprakisht në Dosjen e Tenderit.

AK po e shndërron një mjet potencialisht ndihmës në kriter eliminues

AK kërkon që pajisja të dëshmohet që në fazën e tenderimit me dokument pronësie ose me marrëveshje qiraje/huazimi për projektin.

Në këtë mënyrë, një Operator Ekonomik që posedon personelin profesional, përvojën dhe të gjitha pajisjet kryesore të nevojshme për realizimin e kontratës mund të eliminohet vetëm për shkak se nuk posedon një **detektor metali**, edhe pse Paramasa nuk përmban ndonjë aktivitet të posaçëm të skanimit apo detektimit.

Për një pajisje ndihmëse që mund të sigurohet lehtësisht gjatë realizimit të punimeve nëse paraqitet nevoja, kërkesa për posedim ose qira që në fazën e tenderimit është barrë më e madhe sesa është e nevojshme për të verifikuar aftësinë teknike.

Shkelja e Nenit 7 të LPP-së

Sipas **Nenit 7 të LPP-së**, Autoriteti Kontraktues duhet t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe nuk duhet ta zhvillojë aktivitetin e prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën.

Kërkesa për një pajisje të specializuar, për të cilën nuk është identifikuar aktivitet konkret në Paramasë, mund të përjashtojë operatorë që posedojnë aftësi të plota teknike për realizimin e kontratës, vetëm për shkak të mungesës së një mjeti ndihmës.

Një kufizim i tillë duhet të ketë arsyetim objektiv teknik; në mungesë të tij, efekti është reduktimi i panevojshëm i konkurrencës.

Shkelja e Nenit 51 të LPP-së

Neni 51.1 i LPP-së përcakton se kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se operatorët posedojnë aftësitë profesionale, financiare dhe teknike të nevojshme për realizimin e kontratës.

Ndërsa **Neni 51.3** përcakton shprehimisht se kriteret e përzgjedhjes, dokumentet dhe informatat e kërkuara duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës.**

Në rastin konkret, AK nuk ka identifikuar lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet pajisjes për detektimin e metaleve dhe ndonjë aktiviteti konkret të Paramasës.

Për rrjedhojë, kriteri tejkalon atë që është e nevojshme për verifikimin e aftësisë teknike të OE-së.

Shkelja e Nenit 69 të LPP-së

Neni 69.1 i LPP-së i lejon AK-së të kërkojë dëshmi për aftësinë teknike dhe profesionale, por vetëm **nëse dokumentet e kërkuara janë relevante dhe të nevojshme**.

Për kontratat e punëve, **Neni 69.6.3** lejon kërkimin e raportit për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që OE i ka në dispozicion për realizimin e projektit.

Megjithatë, e drejta për të kërkuar një listë pajisjesh nuk nënkupton se AK mund të kërkojë çfarëdo pajisjeje pa e lidhur me punimet konkrete.

Në këtë rast nuk është dëshmuar që detektori i metaleve është një mjet teknik **relevant dhe i nevojshëm** për realizimin e këtij projekti.

Shkelja e Nenit 25.17 të Rregullores për Prokurimin Publik

Neni 25.17 i Rregullores për Prokurimin Publik përcakton se:

“Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.”

Në rastin konkret, përderisa Paramasa nuk përmban punime të posaçme për skanim apo detektim të metaleve të fshehura, kërkesa që OE të dëshmojë këtë pajisje nuk është e lidhur drejtpërdrejt me objektin konkret të kontratës.

Shkelja e Nenit 25.18 të Rregullores

Neni 25.18 kërkon që AK t'i formulojë kërkesat minimale në mënyrë që të mos përjashtohen operatorët ekonomikë që posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike.

Një OE që nuk posedon detektor metali, por posedon të gjithë kapacitetin tjetër profesional dhe teknik për realizimin e kontratës, nuk duhet të konsiderohet teknikisht i paaftë vetëm për mungesën e një mjeti që nuk është dëshmuar si i domosdoshëm nga Paramasa.

Kërkesa nuk duhet të bazohet në mundësinë hipotetike që pajisja mund të përdoret

Vetëm mundësia që gjatë realizimit të një kontrate renovimi **mund të paraqitet** ndonjë situatë ku një detektor metali do të ishte i dobishëm nuk është e mjaftueshme për ta vendosur atë si kriter minimal.

Nëse do të ndiqej kjo logjikë, AK do të mund të kërkonte një numër shumë të madh veglash dhe pajisjesh ndihmëse vetëm sepse potencialisht mund të përdoren gjatë punimeve.

Testi ligjor është më i ngushtë: kërkesa duhet të jetë **e nevojshme, relevante dhe proporcionale** me kontratën konkrete.

Kërkesa ndaj AK-së

Për arsyet e lartcekura, **kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta largojë në tërësi nga lista e pajisjeve minimale kërkesën:**

“Pajisje për detektimin e metaleve në sipërfaqe të ndryshme – 1 copë.”

PRETENDIMI NR.14

Kërkesa e AK-së

“Cisternë gjysmë-rimorkio min. 2500 deri 5000 l, e cila përdoret për largimin e fekaleve – 1 copë.”

Dëshmia e kërkuar

Për pajisjen/mjetin që i nënshtrohet regjistrimit, Autoriteti Kontraktues kërkon që OE ta dëshmojë posedimin me **librezë valide të regjistrimit**.

Nëse pajisja nuk është në pronësi të Operatorit Ekonomik, kërkohej **marrëveshje për marrjen me qira/huazim në emër të këtij projekti, me validitet për tërë kohëzgjatjen e kontratës, e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.**

Shkeljet e AK-së

Kërkesa për:

“Cisternë gjysmë-rimorkio min. 2500 deri 5000 l, e cila përdoret për largimin e fekaleve”

është një kërkesë që **nuk gjen mbështetje në pozicionet konkrete të Paramasës së punimeve.**

Nga shqyrtimi i plotë i pjesës **“Punët e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit”**, rezulton se punimet e parashikuara përfshijnë kryesisht:

- furnizimin dhe montimin e tubave të ujësjellësit të brendshëm;
- instalimet për ujë të ftohtë dhe ujë të ngrohtë;
- pjesët fazonike dhe lidhëset për ujësjellës;
- kolektorët dhe kutitë shpërndarëse;
- furnizimin dhe montimin e lavamanëve;
- furnizimin dhe montimin e guacave sanitare;
- furnizimin dhe montimin e bojlerëve;
- hidrantët e brendshëm;
- hidrantin e jashtëm;
- gypat e sistemit të hidrantëve;
- pajisjet për sistemin kundër zjarrit.

Megjithëse kapitulli i Paramasës mban emërtimin “Ujësjiellësi dhe Kanalizimi”, në pozicionet konkrete të tij **nuk është paraparë asnjë aktivitet për largimin, pompimin apo transportimin e fekaleve me cisternë.**

Në Paramasë nuk ekziston asnjë pozicion për largim fekalesh

Në dokumentacionin e punimeve nuk është identifikuar asnjë pozicion për:

- **zbrazje të gropës septike;**
- **pastrim apo zbrazje të rezervuarëve septikë;**
- **pompim të ujërave fekale;**
- **largim të ujërave të zeza;**
- **transport të fekaleve jashtë objektit;**
- **pastrim të kolektorëve fekalë;**
- **ndërhyrje në impiant të trajtimit të ujërave të zeza;**
- **pastrim të pusëve të kanalizimit me cisternë;**
- **largim të materialit fekal me mjet të specializuar;**
- **apo ndonjë aktivitet tjetër që kërkon përdorimin e një cisterne për fekale.**

Për rrjedhojë, nuk është e qartë **për cilin pozicion konkret të Paramasës AK e konsideron të domosdoshme këtë pajisje.**

Emërtimi “Ujësjiellësi dhe Kanalizimi” nuk e arsyeton automatikisht cisternën

Fakti që kapitulli i Paramasës është titulluar “**Punët e instalimeve të ujësjiellësit dhe kanalizimit**” nuk mund të përdoret si arsyetim i mjaftueshëm për kërkesën për një cisternë të largimit të fekaleve.

Kërkesat për kapacitetin teknik duhet të bazohen në **pozicionet reale të punimeve që do të realizohen**, dhe jo vetëm në titullin e përgjithshëm të një kapitulli.

Në rastin konkret, pozicionet e listuara në këtë kapitull janë të përqendruara në **ujësjiellësin e brendshëm, pajisjet hidrosanitare dhe sistemin kundër zjarrit.**

Edhe furnizimi dhe montimi i guacave sanitare nuk krijon vetvetiu nevojë për cisternë fekalesh. Montimi i pajisjeve sanitare është punë instalimi dhe lidhjeje me sistemin përkatës të objektit dhe nuk nënkupton se kontraktuesi duhet të kryejë **shërbime të zbrazjes apo transportimit të fekaleve.**

Nëse do të kërkohej një shërbim i tillë, ai do të duhej të ishte i identifikuar në mënyrë të qartë dhe të matshme në Paramasë.

Cisternat për largimin e fekaleve kanë funksion tjetër nga punimet e parashikuara

Një cisternë për largimin e fekaleve është pajisje e specializuar që përdoret për **grumbullimin, pompimin dhe transportimin e ujërave fekale/materialeve të lëngshme nga gropa septike, rezervuarë, puseta apo sisteme të ngjashme.**

Kjo është një veprimtari teknikisht e ndryshme nga:

- montimi i tubave të ujësjellësit;
- montimi i lavamanëve;
- montimi i WC-ve;
- montimi i bojlerëve;
- montimi i hidrantëve;
- apo realizimi i instalimeve të brendshme të ujit.

Prandaj, kërkimi i një pajisjeje të këtij lloji duhet të mbështetet në një **aktivitet konkret të projektuar për pompimin/largimin e fekaleve**, aktivitet i cili nuk rezulton nga Paramasa e analizuar.

AK po kërkon kapacitet për një aktivitet që nuk është pjesë e kontratës

Kriteret e aftësisë teknike duhet të shërbejnë për të vërtetuar se OE është në gjendje të realizojë **punët që janë objekt i kontratës**.

Në rastin konkret, OE detyrohet të dëshmojë se disponon një cisternë të specializuar për largimin e fekaleve, edhe pse në Paramasë nuk është paraparë punë e tillë.

Kështu, OE që posedon:

- pajisjet për realizimin e ujësjellësit;
- pajisjet për instalimet hidrosanitare;
- pajisjet për sistemin kundër zjarrit;
- personelin profesional përkatës;
- dhe të gjitha kapacitetet reale për realizimin e pozicioneve të Paramasës,

mund të konsiderohet se nuk e plotëson kriterin vetëm sepse nuk posedon apo nuk ka marrë me qira një **cisternë për fekale**.

Në këtë mënyrë, kriteri nuk mat aftësinë reale të OE-së për kryerjen e punimeve të tenderuara, por posedimin formal të një pajisjeje që i shërben një aktiviteti që **nuk është evidentuar në Paramasë**.

Kërkesa krijon shpenzim dhe barrë të panevojshme për OE-të

Problemi bëhet edhe më i theksuar për shkak të mënyrës së dëshmimit.

OE që nuk e posedon këtë cisternë duhet të sigurojë marrëveshje qiraje/huazimi **në emër të këtij projekti dhe me validitet për tërë kohëzgjatjen e kontratës**.

Kjo do të thotë se operatorët ekonomikë detyrohen të:

- kërkojnë një pronar të pajisjes;
- negociojnë marrëveshje qiraje;
- rezervojnë pajisjen për këtë projekt;
- dhe marrin përsipër detyrime kontraktuale,

vetëm për të plotësuar një kriter të tenderit, ndonëse nga Paramasa nuk rezulton që pajisja do të përdoret fare.

Një kërkesë e tillë krijon **barrë administrative dhe financiare pa lidhje me nevojën reale të projektit** dhe mund të ndikojë drejtpërdrejt në zvogëlimin e numrit të operatorëve që mund të marrin pjesë.

Edhe kapaciteti “2500 deri 5000 l” është i pambështetur

Përveç mungesës së nevojës për vetë pajisjen, AK ka përcaktuar edhe kapacitetin:

“min. 2500 deri 5000 l”.

Në Paramasë nuk ekziston ndonjë sasi e ujërave fekale që duhet të largohet dhe nuk ekziston ndonjë përlllogaritje që do të arsyetonte:

- 2,500 litra;
- 5,000 litra;
- apo çfarëdo intervali tjetër të kapacitetit të cisternës.

Në mungesë të një sasi të punimeve për largimin e fekaleve, nuk mund të përcaktohet objektivisht as kapaciteti i pajisjes së nevojshme.

Kjo e bën kriterin edhe më të pambështetur teknikisht.

Shkelja e Nenit 7 të LPP-së

Sipas **Nenit 7 të LPP-së**, Autoriteti Kontraktues është i obliguar t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe nuk duhet ta zhvillojë aktivitetin e prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën. Neni ndalon gjithashtu vendosjen e kërkesave ose kriterëve që favorizojnë apo diskriminojnë operatorë ekonomikë.

Në rastin konkret, kushtëzimi i operatorëve me posedimin ose sigurimin me qira të një pajisjeje për një aktivitet që nuk figuron në Paramasë mund të eliminojë OE që posedojnë kapacitet të plotë për realizimin e kontratës.

Efekti kufizues i kriterit nuk mbështetet me ndonjë nevojë të identifikuar teknike.

Shkelja e Nenit 51 të LPP-së

Neni 51 i LPP-së kërkon që kriteret e përzgjedhjes të kufizohen në ato që janë të nevojshme për të vërtetuar aftësinë profesionale dhe teknike për realizimin e kontratës.

Në këtë rast, posedimi i një cisterne për largimin e fekaleve nuk është dëshmuar si kapacitet i nevojshëm për pozicionet konkrete të Paramasës.

Pra, kërkesa nuk është **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën konkrete të kontratës**, pasi pajisja lidhet me një aktivitet të paidentifikuar në punët që do të realizohen.

Shkelja e Nenit 69 të LPP-së

Për kontratat e punëve, **Neni 69.6.3** lejon që AK të kërkojë raport mbi mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që OE ka në dispozicion për realizimin e projektit.

Mirëpo, kjo dispozitë duhet të interpretohet në lidhje me qëllimin e vet: pajisjet e kërkuara duhet të jenë pajisje që nevojiten **për realizimin e projektit konkret**.

Ajo nuk duhet të interpretohet si e drejtë e pakufizuar e AK-së për të kërkuar pajisje që përdoren përgjithësisht në industrinë e ndërtimit apo hidroinstalimeve, por që nuk kanë lidhje me aktivitetet konkrete të kontratës.

Në rastin konkret, mungesa e çdo pozicioni për largimin e fekaleve e bën të pambështetur kërkesën për këtë cisternë.

Shkelja e Nenit 25.17 të Rregullores për Prokurimin Publik

Neni 25.17 i Rregullores Nr. 001/2022, në versionin e konsoliduar me ndryshimet e Rregullores Nr. 002/2024, përcakton se të gjitha kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Kërkesa për cisternën e largimit të fekaleve nuk e plotëson këtë standard, sepse:

- nuk ekziston pozicion për largim fekalesh;
- nuk ekziston sasi e fekaleve që duhet të largohet;
- nuk ekziston pozicion për gropë septike;
- nuk ekziston aktivitet për pompim;
- dhe nuk ekziston përlllogaritje që arsyeton kapacitetin 2,500–5,000 litra.

Për rrjedhojë, pajisja nuk është lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës.

Shkelja e Nenit 25.18 të Rregullores

Neni 25.18 i Rregullores kërkon që AK t'i formulojë kërkesat minimale në mënyrë që të mos përjashtojë operatorë që posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike.

Një Operator Ekonomik që posedon të gjitha pajisjet dhe personelin e nevojshëm për realizimin e ujësjellësit, instalimeve hidrosanitare dhe sistemit kundër zjarrit nuk duhet të konsiderohet teknikisht i paaftë vetëm sepse nuk posedon një cisternë për një shërbim që Paramasa nuk e kërkon.

Mungesa e arsytimit teknik

Nëse Autoriteti Kontraktues pretendon se gjatë realizimit të kontratës duhet të kryhet largimi i fekaleve, atëherë një aktivitet i tillë duhet të jetë i identifikueshëm në dokumentacionin teknik.

AK duhet të përcaktojë së paku:

- vendndodhjen e gropës septike, pusëtës apo rezervuarit që duhet të zbrazet;

- sasinë e parashikuar të fekaleve;
- numrin e zbrazjeve;
- mënyrën e trajtimit dhe transportimit;
- pozicionin përkatës të Paramasës;
- dhe mënyrën e pagesës për këtë aktivitet.

Në mungesë të këtyre të dhënave, kërkesa për cisternë nuk mund të arsyetohet vetëm me supozimin se mund të ketë fekale në një objekt që përmban pajisje sanitare.

Kërkesa ndaj AK-së

Për arsyet e lartcekura, **kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta largojë në tërësi nga lista e pajisjeve minimale kërkesën:**

“Cisternë gjysmë-rimorkio min. 2500 deri 5000 l, e cila përdoret për largimin e fekaleve – 1 copë.”

PRETENDIMI NR.15

Kërkesa e AK-së “Ekskavator me peshë maksimale 900 kg – 1 copë.”

Dëshmia e kërkuar

Për pajisjen/mekanizmin që i nënshtrohet regjistrimit, Autoriteti Kontraktues kërkon që OE ta dëshmojë posedimin përmes **librezës valide të regjistrimit** apo dokumentit tjetër përkatës të pronësisë.

Në rast se OE nuk e posedon pajisjen në pronësi, kërkohet **marrëveshje për marrjen me qira/huazim në emër të këtij projekti, me validitet për tërë kohëzgjatjen e kontratës, e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.**

Shkeljet e AK-së

Nga shqyrtimi i Paramasës së punimeve rezulton se projekti ka të bëjë me **renovimin e objektit ekzistues**, ndërsa në pozicionet e Paramasës nuk janë paraparë punime tipike për të cilat përdorimi i ekskavatorit do të ishte domosdoshmërisht i nevojshëm.

Në veçanti, nga Paramasa nuk rezultojnë pozicione të veçanta për:

- **gërmime të dheut;**
- **hapje të kanaleve;**
- **gërmime për themele;**
- **hapje traseje për instalime nëntokësore;**
- **largim apo ngarkim të dheut;**
- **nivelim të terrenit me ekskavator;**
- **punime të infrastrukturës së jashtme që kërkojnë gërmim mekanik;**
- **gërmime për kanalizim apo ujësjellës të jashtëm.**

Për rrjedhojë, funksioni primar për të cilin përdoret një ekskavator nuk rezulton si aktivitet i veçantë dhe i matshëm në Paramasën e kësaj kontrate.

Pozicioni 1.9 për demolimin e aneksit nuk e arsyeton automatikisht ekskavatorin 900 kg

Në Paramasën e Arkitekturës ekziston **pozicioni 1.9**, ku parashihet:

“Demolimi i aneksit ngjitur me objektin (mbrapa në anën e djathtë të objektit). Demolimi të bëhet me kujdes të shtuar duke mos rrezikuar stabilitetin e objektit. Materiali i demoluar të transportohet deri në deponi të caktuar.”

Nuk kontestohet se për realizimin e këtij pozicioni OE duhet të posedojë pajisje profesionale dhe adekuate për demolim.

Megjithatë, vetë Paramasa **nuk përcakton që demolimi i aneksit duhet domosdoshmërisht të realizohet me ekskavator.**

Përkundrazi, pozicioni e përcakton **rezultatit dhe kushtin e sigurisë** që duhet të arrihet: demolimi duhet të bëhet me kujdes të shtuar dhe pa rrezikuar stabilitetin e objektit ekzistues.

Metoda konkrete e demolimit mund të varet nga:

- dimensionet reale të aneksit;
- materiali prej të cilit është ndërtuar;
- afërsia me konstruksionin ekzistues;
- qasja në objekt;
- kushtet e sigurisë;
- dhe metodologjia profesionale e demolimit e propozuar nga kontraktuesi.

Prandaj, vetëm ekzistenca e një pozicioni për demolim **nuk e arsyeton automatikisht kushtëzimin që OE të posedojë pikërisht një ekskavator me peshë maksimale 900 kg.**

Nuk është arsyetuar pse pesha duhet të jetë “maksimum 900 kg”

Edhe nëse pranohet se një mini-ekskavator mund të jetë i dobishëm për realizimin e një pjese të punimeve të demolimit, mbetet tërësisht e paarsyetuar karakteristika:

“peshë maksimale 900 kg”.

Në Paramasë dhe në përshkrimin e pozicionit 1.9 nuk është dhënë ndonjë informacion që të dëshmojë:

- pse ekskavatori duhet të peshojë jo më shumë se 900 kg;
- pse një ekskavator prej 1,000 kg nuk është i përshtatshëm;
- pse një ekskavator prej 1,200 kg apo 1,500 kg nuk mund ta kryejë punën;
- cili kufizim konstruktiv apo fizik e ka prodhuar kufirin prej 900 kg;

- apo pse një pajisje tjetër profesionale për demolim nuk mund të realizojë të njëjtin funksion.

Në këtë mënyrë, shifra **900 kg** paraqitet si kufi teknik i vendosur pa një përlllogaritje apo arsyetim të identifikueshëm në Paramasë.

Një pajisje me kapacitet më të madh nuk është domosdoshmërisht më pak e përshtatshme

Përcaktimi i një **peshe maksimale** krijon një problem të veçantë proporcionaliteti.

Një Operator Ekonomik mund të posedojë, për shembull:

ekskavator 1,000 kg, 1,200 kg, 1,500 kg apo pajisje tjetër të përshtatshme për demolim,

por të konsiderohet se nuk e plotëson kriterin vetëm për faktin se pajisja e tij tejkalon kufirin formal prej 900 kg.

Përrjashtimi i një pajisjeje vetëm sepse është pak më e rëndë se kufiri i përcaktuar nga AK nuk dëshmon se ajo është teknikisht e paaftë për realizimin e punimeve.

Nëse nuk ekziston një **kufizim real i qasjes, ngarkesës së dyshemesë, dimensioneve të kalimit apo stabilitetit konstruktiv**, nuk ka bazë objektive që pajisja me peshë më të madhe të konsiderohet automatikisht e papranueshme.

Kështu, një OE mund të posedojë pajisje teknikisht plotësisht të aftë, por të eliminohet për shkak të një difference formale në peshën e mekanizmit.

AK nuk ka përcaktuar se çfarë kuptohet me “peshë maksimale 900 kg”

Kërkesa është gjithashtu e paqartë nga aspekti teknik, pasi nuk specifikon se termi:

“peshë maksimale 900 kg”

i referohet:

- peshës operative të ekskavatorit;
- peshës së transportit;
- peshës pa pajisjet shtesë;
- peshës me kovë dhe pajisje pune;
- apo një parametri tjetër teknik.

Pajisjet e mekanizuara mund të kenë masa të ndryshme të deklaruara nga prodhuesi varësisht nga konfigurimi dhe pajisjet e montuara.

Për rrjedhojë, edhe vetë mënyra e formulimit të kriterit krijon paqartësi gjatë dëshmimit dhe vlerësimit të ofertave.

Kërkesa përcakton metodologjinë e demolimit pa qenë kjo e kërkuar nga Paramasa

Paramasa kërkon që aneksi të demolohet dhe materiali të largohet, ndërsa njëkohësisht kërkon që demolimi të kryhet me kujdes të shtuar për të mos rrezikuar stabilitetin e objektit.

AK duhet të sigurohet se OE posedon **kapacitet teknik për realizimin e sigurt të demolimit**, por kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht të drejtën për të përcaktuar paraprakisht një lloj dhe peshë specifike të mekanizmit, nëse i njëjti rezultat mund të arrihet në mënyrë profesionale me pajisje të tjera.

Në varësi të kushteve reale, demolimi mund të realizohet me:

- mini-ekskavator;
- pajisje hidraulike për demolim;
- çekan elektrik ose pneumatik;
- mjete mekanike;
- kombinim të metodave manuale dhe mekanike;
- ose pajisje tjetër profesionale ekuivalente.

Prandaj, **qëllimi i kriterit duhet të jetë sigurimi i kapacitetit për demolim, jo posedimi i një ekskavatori me peshë të përcaktuar në mënyrë rigide.**

Kërkesa mund të eliminojë OE teknikisht të aftë

Një Operator Ekonomik mund të posedojë:

- përvojën profesionale përkatëse;
- personel të kualifikuar;
- pajisje të sigurta për demolim;
- mekanizëm tjetër adekuat;
- dhe kapacitet të plotë për realizimin e pozicionit 1.9,

por të eliminohet vetëm sepse nuk posedon apo nuk ka marrë me qira një ekskavator që plotëson pikërisht kufirin:

“maksimum 900 kg”.

Kjo e zhvendos vlerësimin nga **aftësia reale teknike për realizimin e kontratës** në përputhjen formale me një karakteristikë të vetme të pajisjes.

Shkelja e Nenit 7 të LPP-së

Sipas **Nenit 7 të LPP-së**, AK duhet t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe nuk duhet ta zhvillojë aktivitetin e prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën. Neni 7 ndalon gjithashtu vendosjen e kërkesave ose kriterëve të përzgjedhjes që favorizojnë apo diskriminojnë operatorë ekonomikë.

Në rastin konkret, vendosja e kufirit “**maksimum 900 kg**”, pa arsyetim teknik objektiv, mund të eliminojë OE që posedojnë ekskavatorë apo pajisje të tjera adekuate vetëm për shkak të një parametri formal.

Shkelja e Nenit 51 të LPP-së

Sipas **Nenit 51.1 të LPP-së**, kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar që operatorët ekonomikë posedojnë aftësitë profesionale, financiare dhe teknike të nevojshme për realizimin e kontratës.

Ndërsa **Neni 51.3** përcakton se kriteret e përzgjedhjes, dokumentet dhe informatat e kërkuara duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës**.

Në rastin konkret, mund të jetë relevante që OE të posedojë **pajisje adekuate për demolim**, por nuk është dëshmuar se është relevante dhe proporcionale që ajo pajisje të jetë domosdoshmërisht:

“Ekskavator me peshë maksimale 900 kg”.

Qëllimi mund të arrihet përmes një kriteri dukshëm më pak kufizues, i cili kërkon kapacitetin real për realizimin e demolimit dhe lejon pajisje ekuivalente.

Shkelja e Nenit 69 të LPP-së

Neni 69.1 i LPP-së lejon që AK të kërkojë dëshmi për aftësinë teknike dhe profesionale, mirëpo shprehimisht e lidh këtë mundësi me dokumentet dhe kapacitetet që janë **relevante dhe të nevojshme**.

Pra, fakti që AK mund të kërkojë listë të pajisjeve nuk do të thotë se mund të kërkojë një pajisje me çfarëdo parametri teknik pa e lidhur atë me nevojën reale të projektit.

Në këtë rast, nuk është dëshmuar pse kufiri maksimal prej 900 kg është i nevojshëm për realizimin e punimeve.

Shkelja e Nenit 25.17 të Rregullores për Prokurimin Publik

Neni 25.17 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, në versionin e konsoliduar me ndryshimet e Rregullores Nr. 002/2024, përcakton se të gjitha kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës**.

Në rastin konkret, AK nuk ka dëshmuar lidhjen proporcionale ndërmjet demolimit të një aneksi dhe kufizimit të pajisjes në një ekskavator me peshë **maksimum 900 kg**.

Shkelja e Nenit 25.18 të Rregullores

Neni 25.18 kërkon që AK t'i formulojë kërkesat minimale në mënyrë që të mos përjashtojë operatorë ekonomikë që posedojnë **aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike**.

Një OE që posedon një ekskavator pak më të rëndë apo pajisje tjetër profesionale të përshtatshme për demolim mund të posedojë plotësisht kapacitetin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës.

Eliminimi i tij vetëm për shkak të mosplotësimit të kufirit formal prej 900 kg është pikërisht lloji i kufizimit që duhet të shmanget kur aftësia teknike reale është e mjaftueshme.

Kërkesa duhet të lidhet me funksionin dhe jo me peshën arbitrare të mekanizmit

Nëse qëllimi real i AK-së është sigurimi i një mekanizmi të vogël për demolimin e aneksit pa rrezikuar objektin ekzistues, atëherë kriteri mund të përshkruhet përmes **funksionit dhe përshtatshmërisë për punën konkrete**.

AK nuk ka nevojë të përcaktojë një kufi absolut prej 900 kg, përderisa nuk dëshmon se çdo mekanizëm mbi këtë peshë është teknikisht i papërshtatshëm.

Një formulim funksional do të ruante qëllimin e AK-së, por njëkohësisht do të lejonte konkurrencë ndërmjet OE-ve që posedojnë pajisje të ndryshme, por teknikisht të afta.

Kërkesa ndaj AK-së

Për arsyet e lartcekura, **kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta largojë nga lista e pajisjeve minimale kriterin në formën aktuale:**

“Ekskavator me peshë maksimale 900 kg – 1 copë.”

PRETENDIMI NR.16

Kërkesa e AK-së

“Kamion kiper me peshë bartëse max. 5 ton, të jetë me pajisje përcjellëse me graifer – 1 copë.”

Dëshmia e kërkuar

Për automjetin që i nënshtrohet regjistrimit, Autoriteti Kontraktues kërkon që OE ta dëshmojë posedimin me **librezë valide të regjistrimit**.

Në rast se automjeti nuk është në pronësi të Operatorit Ekonomik, kërkohet **marrëveshje për marrjen me qira/huazim në emër të këtij projekti, me validitet për tërë kohëzgjatjen e kontratës, e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët**.

Shkeljet e AK-së

Nga shqyrtimi i Paramasës rezulton se projekti përmban disa pozicione të demolimit, demontimit, grumbullimit dhe transportimit të materialeve dhe mbeturinave ndërtimore.

Në Paramasën e Arkitekturës janë paraparë, ndër të tjera:

- demolimi i mureve të brendshme;

- demontimi i dyerve dhe dritareve ekzistuese;
- demontimi i pajisjeve sanitare;
- demolimi i pllakave dhe dysHEMEVE;
- demolimi i elementeve të plafonit;
- demolimi i aneksit ngjitur me objektin;
- largimi i materialeve të krijuara gjatë renovimit të kulmit;
- grumbullimi, ngarkimi, transportimi dhe deponimi i mbeturinave.

Pra, nuk kontestohet nevoja që OE të ketë kapacitet adekuat për grumbullimin, ngarkimin dhe transportimin e materialeve dhe mbeturinave ndërtimore.

Megjithatë, kontestohet mënyra se si Autoriteti Kontraktues e ka specifikuar këtë kapacitet, duke kërkuar domosdoshmërisht:

“Kamion kiper + peshë bartëse maksimum 5 ton + graifer”.

Paramasa nuk kërkon që ngarkimi të realizohet me graifer

Nga pozicionet konkrete të Paramasës rezulton kërkesa për:

grumbullim, ngarkim, transportim dhe deponim të materialeve të demoluara, por nuk rezulton askund se operacioni i ngarkimit duhet të realizohet domosdoshmërisht me graifer.

Paramasa nuk përmban pozicion të veçantë për:

- ngarkim të materialeve me graifer;
- manipulim të materialeve me kapëse hidraulike;
- selektim të materialit me graifer;
- ngarkim të materialeve të rënda me graifer;
- apo ndonjë aktivitet tjetër për të cilin kjo pajisje specifike është domosdoshmërisht e nevojshme.

Në këtë mënyrë, AK po përcakton jo vetëm rezultatin që duhet të arrihet, por edhe **mjetin dhe metodën konkrete të ngarkimit**, pa e lidhur këtë metodë me ndonjë pozicion specifik të Paramasës.

Ngarkimi mund të realizohet me pajisje të ndryshme ekuivalente

Funksioni që kërkohet nga Paramasa është **ngarkimi dhe largimi i mbeturinave**.

Ky funksion mund të realizohet me mjete dhe metoda të ndryshme profesionale, varësisht nga lloji dhe dimensionet e materialeve, për shembull përmes:

- ngarkimit mekanik;
- mini-ekskavatorit me kovë;
- ngarkuesit;
- pajisjeve ngritëse;
- krahut hidraulik;

- ngarkimit manual për materialet e përshtatshme;
- ose pajisjeve të tjera ekuivalente.

Për rrjedhojë, nuk është e arsyeshme që një OE të konsiderohet teknikisht i paaftë për realizimin e kontratës vetëm për shkak se kamioni i tij nuk është i pajisur pikërisht me **graifer**, përderisa ai disponon mjete të tjera të sigurt dhe adekuate për ngarkimin e mbeturinave.

Graiferi është karakteristikë tepër specifike dhe nuk dëshmon vetvetiu aftësinë teknike

Kriteri minimal duhet të vërtetojë **kapacitetin real të OE-së për realizimin e punimeve**, dhe jo posedimin e një konfigurimi të veçantë të një automjeti.

Një Operator Ekonomik mund të posedojë:

- kamion kiper;
- pajisje të veçantë për ngarkim;
- mekanizëm tjetër profesional për manipulimin e materialeve;

dhe në tërësi të ketë kapacitet më se të mjaftueshëm për largimin e mbeturinave.

Megjithatë, sipas formulimit aktual, një operator i tillë mund të eliminohet vetëm sepse **graiferi nuk është i montuar apo i lidhur me kamionin e kërkuar**.

Kjo tregon se kriteri nuk mat rezultatin funksional, por një **konfigurim specifik të mekanizmit**.

Edhe kufizimi “peshë bartëse max. 5 ton” është i paarsyetuar

Përveç graiferit, AK ka vendosur edhe kufizimin:

“peshë bartëse max. 5 ton”.

Nga Paramasa nuk rezulton ndonjë bazë teknike që arsyeton pse kamioni duhet të ketë kapacitet bartës **jo më të madh se 5 ton**.

Nuk është identifikuar:

- ndonjë kufizim i rrugës së qasjes;
- ndonjë kufizim i kapacitetit bartës të terrenit;
- ndonjë kufizim konstruktiv;
- ndonjë kufizim i hyrjes në kantier;
- ndonjë kufizim i hapësirës së manovrimit;
- apo ndonjë kusht tjetër që do të përjashtonte një kamion me kapacitet më të madh.

Për rrjedhojë, një OE që posedon, për shembull, një kamion kiper me kapacitet **6 ton, 7 ton apo më shumë**, mund të ketë kapacitet teknik më të madh për transportimin e

materialeve, por megjithatë të mos e plotësojë kriterin vetëm sepse tejkalon kufirin formal prej 5 tonësh.

Kjo nuk është logjikë proporcionale e vlerësimit të kapacitetit teknik.

Kapaciteti më i madh nuk e bën automjetin teknikisht më pak të aftë

Nëse qëllimi është largimi i mbeturinave, një automjet me kapacitet bartës më të madh në parim mund të bartë edhe një ngarkesë më të vogël.

Prandaj, kufizimi **“maksimum 5 ton”** duhet të mbështetet në një arsye konkrete të projektit.

Në mungesë të një arsyeje të tillë, kufiri maksimal nuk shërben për të siguruar një aftësi minimale teknike, por përkundrazi **përfshihet pajisje me kapacitet më të madh.**

Një kriter i aftësisë teknike duhet, nëse është e nevojshme, të përcaktojë **kapacitetin minimal të nevojshëm**, dhe jo një kufi maksimal që nuk buron nga kushtet e objektit.

Paramasa kërkon rezultat dhe jo një teknologji të vetme transporti

Në pozicionet ku kërkohet largimi i materialeve, Paramasa përdor formulime si:

“transporti deri në deponi të caktuar”,
“grumbullimi, ngarkimi, transportimi dhe deponimi”,
ose formulime të ngjashme.

Pra, dokumentacioni teknik përcakton **rezultatit e punës**, ndërsa nuk përcakton metodologjinë sipas së cilës ky rezultat duhet të realizohet vetëm me graifer.

Për rrjedhojë, OE duhet të jetë përgjegjës që të zgjedhë kombinimin e pajisjeve që e realizon këtë funksion në mënyrë profesionale, të sigurt dhe efikase.

Kërkesa krijon barrë të panevojshme në fazën e tenderimit

OE që nuk posedon pikërisht një kamion kiper deri në 5 ton me graifer duhet të lidhë marrëveshje qiraje/huazimi për këtë projekt dhe për tërë kohëzgjatjen e kontratës.

Kështu, një Operator Ekonomik që disponon me mjete të tjera plotësisht të përshtatshme për ngarkimin dhe transportimin e mbeturinave detyrohet të sigurojë një automjet shtesë vetëm për t'u përshtatur me kriterin formal të tenderit.

Kjo krijon:

- barrë financiare shtesë;
- barrë administrative;
- nevojë për sigurimin artificial të pajisjes;
- si dhe rrezik të eliminimit të OE-ve që realisht e posedojnë kapacitetin teknik të nevojshëm.

Shkelja e Nenit 7 të LPP-së

Sipas **Nenit 7 të LPP-së**, Autoriteti Kontraktues duhet t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe nuk duhet ta zhvillojë aktivitetin e prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën.

Në rastin konkret, kushtëzimi me një konfigurim tepër specifik:

“kamion kiper + maksimum 5 ton + graifer”

mund të eliminojë operatorë që posedojnë kapacitet real për ngarkimin dhe transportimin e mbeturinave, por përdorin një kombinim tjetër të pajisjeve.

Përderisa Paramasa nuk e përcakton graiferin si domosdoshmëri dhe nuk arsyeton kufirin maksimal prej 5 tonësh, efekti kufizues i kriterit nuk mbështetet në një nevojë objektive të projektit.

Shkelja e Nenit 51 të LPP-së

Sipas **Nenit 51 të LPP-së**, kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen në ato që janë të nevojshme për vërtetimin e aftësive teknike dhe profesionale dhe duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës**.

Në rastin konkret:

- nevoja për transport është relevante;
- nevoja për ngarkim të mbeturinave është relevante;

por nuk është dëshmuar se është relevante dhe proporcionale që këto funksione të realizohen domosdoshmërisht me një **kamion kiper me graifer dhe me peshë bartëse jo më shumë se 5 ton**.

Qëllimi mund të arrihet përmes një kriteri funksional dukshëm më pak kufizues.

Shkelja e Nenit 69 të LPP-së

Neni 69 i LPP-së lejon që Autoriteti Kontraktues, për kontratat e punëve, të kërkojë dëshmi për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që OE i ka në dispozicion për realizimin e projektit.

Megjithatë, kjo e drejtë nuk e përjashton detyrimin që pajisjet e kërkuara të jenë **relevante dhe të nevojshme për realizimin e projektit konkret**.

Në këtë rast, AK nuk ka dëshmuar:

- pse graiferi është i domosdoshëm;
- pse një mjet tjetër ngarkues nuk është ekuivalent;
- pse kamioni duhet të ketë maksimum 5 ton;
- dhe pse një automjet me kapacitet më të madh nuk mund të përdoret.

Për rrjedhojë, konfigurimi i kërkuar tejkalon atë që është e nevojshme për vërtetimin e aftësisë teknike.

Shkelja e parimit të proporcionalitetit sipas Rregullores për Prokurimin Publik

Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, në versionin e konsoliduar me ndryshimet e Rregullores Nr. 002/2024, rregullon formulimin e kërkesave minimale të kualifikimit dhe kërkon lidhjen e tyre me objektin dhe nevojat reale të kontratës.

Në rastin konkret, kriteri nuk është formuluar mbi bazën e funksionit:

“ngarkim dhe transport i mbeturinave”

por mbi bazën e një konfigurimi të posaçëm teknik të automjetit.

Një kriter më proporcional do të lejonte që OE të dëshmojë kapacitetin e nevojshëm përmes çdo kombinimi adekuat dhe ekuivalent të pajisjeve.

AK duhet të arsyetojë veçmas edhe “graiferin” edhe “maksimum 5 ton”

Nëse Autoriteti Kontraktues konsideron se ky konfigurim është domosdoshmërisht i nevojshëm, nuk mjafton të deklarojë në mënyrë të përgjithshme se nevojitet transporti i mbeturinave.

AK duhet të dëshmojë në mënyrë konkrete:

pse nevojitet graiferi dhe, veçmas, pse nevojitet kufizimi maksimal prej 5 tonësh.

Këto janë dy karakteristika teknike të ndryshme dhe secila duhet të ketë arsyetimin e vet në raport me punimet.

Vetëm fakti se krijohen mbeturina gjatë renovimit nuk provon asnjërën prej tyre.

Kërkesa ndaj AK-së

Për arsytet e lartcekura, **kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta largojë nga lista e pajisjeve minimale kërkesën në formën aktuale:**

“Kamion kiper me peshë bartëse max. 5 ton, të jetë me pajisje përcjellëse me graifer – 1 copë.”

PRETENDIMI NR.17

Kërkesa e AK-së “Traktorë pirun – lartësia e ngritjes 3.00 m, 1 copë.”

Dëshmia e kërkuar

Për pajisjen/mekanizmin, Autoriteti Kontraktues kërkon që OE ta dëshmojë posedimin përmes **dokumentit të pronësisë dhe/ose dokumentit të regjistrimit**, varësisht nga natyra e pajisjes.

Në rast se OE nuk e posedon pajisjen në pronësi, kërkohet **marrëveshje për marrjen me qira/huazim në emër të këtij projekti, me validitet për tërë kohëzgjatjen e kontratës, e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.**

Shkeljet e AK-së

Nga shqyrtimi i Paramasës së punimeve nuk rezulton ndonjë pozicion konkret që kërkon domosdoshmërisht përdorimin e një **traktori pirun/forklift me lartësi ngritjeje 3.00 m.**

Paramasa nuk parasheh ndonjë aktivitet të veçantë për:

- **ngarkim ose shkarkim sistematik të materialeve të paletizuara me traktor pirun;**
- **magazinim të materialeve në rafte industriale;**
- **manipulim të paletave në depo;**
- **ngritje të pajisjeve ose materialeve në lartësinë pikërisht 3.00 m;**
- **transport të brendshëm të materialeve me forklift;**
- **manipulim të elementeve të rënda për të cilat traktor-piruni është mjeti i vetëm teknikisht i përshtatshëm.**

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar **pozicionin konkret të Paramasës** për të cilin kjo pajisje është e domosdoshme.

Furnizimi me materiale nuk e arsyeton automatikisht posedimin e traktorit pirun

Fakti se kontrata përfshin furnizim me materiale dhe pajisje ndërtimore nuk do të thotë automatikisht se Operatorit Ekonomik duhet t'i kërkohet të posedojë ose marrë me qira një traktor pirun.

Në çdo kontratë ndërtimore ekziston në një masë të caktuar:

- furnizimi me materiale;
- shkarkimi i materialeve;
- bartja e materialeve brenda punishtes;
- dhe manipulimi i tyre gjatë montimit.

Megjithatë, nga kjo nuk mund të nxirret përfundimi se **traktori pirun duhet të jetë kriter minimal i detyrueshëm për kualifikim**, përveç nëse natyra, pesha, sasia ose mënyra e montimit të materialeve e bën këtë pajisje konkretisht të domosdoshme.

Në rastin konkret, një domosdoshmëri e tillë nuk është identifikuar në Paramasë.

Nuk është arsyetuar parametri “lartësia e ngritjes 3.00 m”

Përveç kërkesës për vetë traktorin pirun, AK ka përcaktuar edhe karakteristikën:

“lartësia e ngritjes 3.00 m”.

Në Paramasë nuk është identifikuar ndonjë element, material apo pajisje që:

- duhet të ngrihet pikërisht në 3.00 m;
- duhet të vendoset në raft ose platformë në këtë lartësi;
- nuk mund të montohet me mjete të tjera;
- apo kërkon teknikisht përdorimin e një piruni me këtë lartësi ngritjeje.

Pra, parametri **3.00 m** nuk është i lidhur me ndonjë pozicion, përllogaritje apo kërkesë konkrete të Paramasës.

Nëse AK konsideron se duhet të ekzistojë kapacitet për ngritje të materialeve, atëherë duhet të përcaktojë **funksionin real dhe kapacitetin e nevojshëm**, duke u bazuar në materialet/pajisjet që do të manipulohen.

Funksioni mund të realizohet me pajisje të tjera ekuivalente

Edhe nëse gjatë realizimit të kontratës paraqitet nevoja për ngritje apo manipulim të materialeve, ky funksion mund të realizohet përmes mjeteve të ndryshme profesionale, varësisht nga situata konkrete.

Mund të përdoren, sipas nevojës:

- pajisje ngritëse;
- vinç;
- kran;
- kamion me kran;
- platformë ngritëse;
- pajisje manuale ose mekanike për manipulim;
- ose pajisje tjetër teknikisht ekuivalente.

Prandaj, AK nuk duhet të imponojë **një metodë të vetme të manipulimit të materialeve**, përderisa i njëjti rezultat mund të arrihet në mënyrë të sigurt dhe profesionale me pajisje të tjera.

Qëllimi duhet të jetë që OE të posedojë **kapacitetin real për ngritje dhe manipulim të materialeve**, dhe jo që të posedojë pikërisht një traktor pirun.

Kërkesa e shndërron metodologjinë e punës në kriter minimal eliminues

Mënyra se si Operatorët Ekonomikë organizojnë:

- pranimin e materialeve;
- shkarkimin;
- magazinimin;
- bartjen;
- dhe ngritjen e tyre,

është pjesë e organizimit dhe metodologjisë së realizimit të punimeve, për sa kohë respektohen kërkesat teknike dhe të sigurisë.

AK, duke kërkuar domosdoshmërisht traktor pirun, po e shndërron **një metodë të mundshme të organizimit të punimeve në kriter minimal për kualifikim.**

Një OE mund të ketë metodologji tjetër plotësisht funksionale dhe të sigurt për manipulimin e materialeve, por të eliminohet vetëm sepse nuk posedon ose nuk ka marrë me qira një forklift.

Kjo nuk dëshmon mungesë të aftësisë teknike të operatorit.

Pajisja nuk është dëshmuar si e domosdoshme për realizimin e kontratës

Ekziston dallim ndërmjet një pajisjeje që **mund të jetë e dobishme** gjatë realizimit të një kontrate dhe një pajisjeje që është **e domosdoshme në atë masë sa mungesa e saj duhet të rezultojë në eliminimin e OE-së nga tenderi.**

Për ta vendosur një pajisje si kriter minimal, AK duhet të jetë në gjendje ta lidhë atë me natyrën dhe vëllimin konkret të punimeve.

Në këtë rast, nuk është treguar se realizimi i ndonjë pozicioni të Paramasës është i pamundur ose teknikisht i papërshtatshëm pa traktor pirun.

Kërkesa krijon barrë të panevojshme për Operatorët Ekonomikë

Një OE që nuk posedon traktor pirun duhet, sipas kërkesës së AK-së, të sigurojë marrëveshje qiraje/huazimi për këtë projekt dhe për kohëzgjatjen e kontratës.

Kjo krijon detyrim që OE:

- të gjejë pronar të pajisjes;
- të lidhë marrëveshje për projektin;
- të rezervojë pajisjen;
- dhe potencialisht të marrë përsipër kosto financiare,

për një pajisje për të cilën **nuk është identifikuar aktivitet konkret në Paramasë.**

Në këtë mënyrë, kriteri krijon barrë administrative dhe financiare pa u dëshmuar se ajo barrë është e nevojshme për realizimin e kontratës.

Shkelja e Nenit 7 të LPP-së

Sipas **Nenit 7 të LPP-së**, Autoriteti Kontraktues duhet t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe nuk duhet ta zhvillojë aktivitetin e prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën.

Vendosja e një pajisjeje specifike si kriter minimal, pa u dëshmuar domosdoshmëria e saj nga Paramasa, mund të përjashtojë OE që posedojnë kapacitet të plotë teknik dhe mjete të tjera adekuate për manipulimin e materialeve.

Për rrjedhojë, kriteri mund të zvogëlojë konkurrencën për një arsye që nuk lidhet me aftësinë reale të OE-së për realizimin e kontratës.

Shkelja e Nenit 51 të LPP-së

Sipas **Nenit 51 të LPP-së**, kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në ato që janë të nevojshme për vërtetimin e aftësisë profesionale dhe teknike të operatorëve ekonomikë dhe duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës**.

Në rastin konkret, mund të jetë relevante që OE të ketë kapacitet për manipulimin dhe ngritjen e materialeve.

Megjithatë, nuk është dëshmuar se ky kapacitet duhet të realizohet pikërisht përmes:

“Traktorit pirun me lartësi ngritjeje 3.00 m”.

Qëllimi i njëjtë mund të arrihet përmes një kërkesë shumë më pak kufizuese dhe funksionale, duke lejuar pajisje ekuivalente.

Shkelja e Nenit 69 të LPP-së

Neni 69 i LPP-së i mundëson Autoritetit Kontraktues të kërkojë dëshmi lidhur me mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që OE i ka në dispozicion për realizimin e projektit.

Megjithatë, kjo e drejtë nuk mund të interpretohet si autorizim që AK të kërkojë çfarëdo pajisjeje që mund të përdoret potencialisht gjatë një kontrate ndërtimore.

Pajisja duhet të ketë lidhje objektive me punimet dhe të jetë e nevojshme për realizimin e projektit konkret.

Në këtë rast, AK nuk ka treguar:

- për cilin aktivitet nevojitet traktori pirun;
- çfarë materiali do të manipulohet me të;
- çfarë peshe ka materiali;
- pse duhet ngritje në 3.00 m;
- dhe pse pajisje të tjera ngritëse nuk mund të përdoren.

Për rrjedhojë, domosdoshmëria e kriterit nuk është e dëshmuar.

Shkelja e kërkesës për relevancë dhe proporcionalitet sipas Rregullores për Prokurimin Publik

Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, në versionin e konsoliduar me ndryshimet e Rregullores Nr. 002/2024, rregullon kërkesat minimale të kualifikimit dhe kërkon që ato të lidhen me kapacitetet e nevojshme për objektin konkret të kontratës.

Në rastin konkret, AK ka kërkuar një pajisje të caktuar dhe një karakteristikë të caktuar teknike – **3.00 m lartësi ngritjeje** – pa identifikuar bazën konkrete të këtyre parametrave.

Një kërkesë proporcionale duhet të lidhet me **funksionin real që duhet të realizohet**, dhe jo me një lloj të vetëm mekanizmi nëse ekzistojnë zgjidhje të tjera teknikisht të përshtatshme.

AK duhet të dëshmojë domosdoshmërinë e pajisjes

Nëse Autoriteti Kontraktues konsideron se traktori pirun është absolutisht i nevojshëm për realizimin e kësaj kontrate, atëherë duhet të jetë në gjendje të identifikojë:

- materialin konkret që do të ngrihet;
- peshën e tij;
- vendin ku do të ngrihet;
- lartësinë e nevojshme;
- numrin e operacioneve të ngritjes;
- dhe arsyen pse një pajisje tjetër ngritëse nuk mund të përdoret.

Vetëm deklarimi i përgjithshëm se kontrata përmban furnizim dhe montim materialesh **nuk është arsyetim i mjaftueshëm për ta bërë traktori pirun kriter minimal eliminues.**

Kërkesa ndaj AK-së

Për arsyet e lartcekura, **kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta largojë në tërësi nga lista e pajisjeve minimale kërkesën:**

“Traktorë pirun – lartësia e ngritjes 3.00 m, 1 copë.”

PRETENDIMI NR.18

Kërkesa e AK-së

“Pajisje për nivelizim, kapaciteti minimum 4 m³ në orë, distanca e dërgesës horizontal minimum 150 m, distanca e dërgesës vertikal minimum 50 m.”

Dëshmia e kërkuar

Për pajisjen që nuk i nënshtrohet regjistrimit, Autoriteti Kontraktues kërkon që OE ta dëshmojë posedimin përmes **faturës së shoqëruar me dëshmi të transaksionit, DUD-it apo dokumentit tjetër përkatës të pronësisë.**

Në rast se OE nuk e posedon pajisjen në pronësi, kërkohet **marrëveshje për marrjen me qira/huazim në emër të këtij projekti, me validitet për tërë kohëzgjatjen e kontratës, e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.**

Shkeljet e AK-së

Nga shqyrtimi i Paramasës së punimeve të dyshemeve rezulton se janë paraparë lloje të ndryshme të përfundimit të dyshemeve, përfshirë:

- **dysHEME epoksi;**
- **laminat;**
- **pllaka qeramike;**
- **granit;**
- **terracer;**

- tepih.

Megjithatë, nga pozicionet e identifikuara në Paramasë **nuk rezulton ndonjë aktivitet i posaçëm që kërkon pompim apo dërgim mekanik të materialit nivelizues në distancat dhe kapacitetet e përcaktuara nga AK.**

Në veçanti, nuk është identifikuar pozicion për:

- pompim të estrihut;
- pompim të materialit vetënivelizues;
- pompim të llaçit për nivelizim;
- betonim me pompë;
- prodhim dhe dërgim të materialit nivelizues me kapacitet të përcaktuar në $\text{m}^3/\text{orë}$;
- dërgim horizontal të materialit në distancë 150 m;
- dërgim vertikal të materialit në lartësi 50 m.

Për rrjedhojë, nuk kontestohet se gjatë realizimit të dysHEMEVE mund të nevojitet përgatitje dhe rrafshim i nënshtresës sipas kërkesave të secilit material përfundimtar, por kjo **nuk e arsyeton automatikisht kërkesën për një pajisje industriale me parametrat specifikë $4 \text{ m}^3/\text{h}$, 150 m horizontalisht dhe 50 m vertikalisht.**

AK ka përcaktuar tre parametra teknikë pa i lidhur me ndonjë pozicion konkret

Kërkesa e AK-së nuk është e përgjithshme për një mjet nivelizimi. Ajo përcakton njëkohësisht tre karakteristika konkrete:

1. kapacitet minimum $4 \text{ m}^3/\text{orë}$;
2. distancë dërgese horizontale minimum 150 m;
3. distancë dërgese vertikale minimum 50 m.

Secili prej këtyre parametrave duhet të ketë bazë në nevojat reale të projektit.

Në dokumentacionin e analizuar nuk është evidentuar ndonjë përllogaritje që tregon:

- sa m^3 material duhet të pompohet;
- çfarë lloj materiali do të pompohet;
- në çfarë kohe duhet të përpunohet;
- sa është distanca reale ndërmjet vendit të përgatitjes dhe vendit të aplikimit;
- apo pse nevojitet kapacitet për dërgim vertikal deri në 50 m.

Në mungesë të këtyre të dhënave, parametrat e vendosur duken të shkëputur nga sasitë dhe kushtet reale të kontratës.

Parametri “minimum 4 m^3 në orë” nuk është i mbështetur me sasi të Paramasës

Kapaciteti prej:

“minimum 4 m^3 në orë”

është tregues i produktivitetit të pajisjes.

Për të arsyetuar një produktivitet minimal të tillë, AK duhet të ketë një volum të identifikueshëm materiali që duhet të përgatitet, pompohet apo shpërndahet brenda një periudhe të caktuar.

Mirëpo, në pozicionet e përmendura të dyshemeve nuk është identifikuar një sasi e materialit nivelizues e shprehur në m^3 , mbi bazën e së cilës mund të arsyetohet se pajisja duhet të ketë kapacitet pikërisht **minimum 4 m^3 /orë**.

Për shembull, një kërkesë e tillë do të mund të arsyetohej vetëm nëse AK do të kishte përcaktuar një volum të konsiderueshëm estrihu apo materiali tjetër pompues dhe një afat realizimi që kërkon këtë produktivitet.

Një lidhje e tillë nuk është evidentuar.

Distanca horizontale “minimum 150 m” nuk është arsyetuar

AK ka kërkuar gjithashtu që pajisja të jetë e aftë për:

“distanca të dërgesës horizontal minimum 150 m”.

Mirëpo, Paramasa nuk identifikon ndonjë situatë ku materiali duhet të pompohet nga pajisja deri në pikën e aplikimit në një distancë horizontale prej të paktën 150 metrash.

Nuk është paraqitur:

- plan organizimi i kantierit që e kërkon këtë distancë;
- kufizim që pengon vendosjen e pajisjes më afër objektit;
- trase konkrete e dërgimit prej 150 m;
- apo pozicion i punimeve që e kërkon këtë performancë.

Prandaj, nuk është e qartë **nga cili dimension real i objektit apo kantierit është nxjerrë pikërisht shifra 150 m**.

Distanca vertikale “minimum 50 m” është veçanërisht e paarsyetuar

Edhe më problematik është parametri:

“distanca e dërgesës vertikal minimum 50 m”.

Nga përshkrimi i projektit dhe punimeve të identifikuara, punimet zhvillohen në objektin ekzistues në përdhese dhe katin e parë, si dhe në pjesën e kulmit.

Në këto rrethana, kërkesa që pajisja të jetë e aftë të dërgojë material në **lartësi vertikale minimum 50 m** duhet të mbështetet me një të dhënë konkrete të projektit.

Nëse objekti nuk kërkon pompim të materialit në një lartësi të tillë, atëherë ky parametër paraqet **kapacitet teknik dukshëm më të madh se nevoja reale e kontratës**.

AK duhet të tregojë se cili pozicion i punimeve ndodhet në lartësi që kërkon 50 m dërgesë vertikale. Në mungesë të kësaj lidhjeje, parametri nuk është proporcional me objektin e kontratës.

Lloji i pajisjes nuk është përcaktuar qartë

Formulimi:

“Pajisje për nivelizim”

është gjithashtu i paqartë.

Vetëm nga parametrat **4 m³/orë, 150 m horizontalisht dhe 50 m vertikalisht** mund të kuptohet se AK kërkon një pajisje që jo vetëm nivelizon, por edhe **përgatit/pompon/dërgon material në distancë.**

Megjithatë, AK nuk ka specifikuar:

- çfarë materiali duhet të përpunojë pajisja;
- nëse bëhet fjalë për estrih;
- material vetënivelizues;
- llaç;
- beton;
- apo material tjetër.

Kjo është problematike edhe për dëshmimin e kriterit, sepse OE duhet të paraqesë faturë apo dokument pronësie për një pajisje, pa qenë e përcaktuar qartë **çfarë lloj pajisjeje konsiderohet e pranueshme nga AK.**

Punimet e dysHEMEVE nuk e arsyetojnë automatikisht pajisjen e kërkuar

Fakti që Paramasa përmban punime të dysHEMEVE nuk do të thotë se çdo lloj makinerie që përdoret potencialisht në realizimin e dysHEMEVE mund të vendoset si kriter minimal.

DysHEMEJA me laminat, pllaka qeramike, granit, tepih apo epoksi mund të kërkojë përgatitje të nënshtresës, por **metodologjia konkrete e përgatitjes dhe nivelizimit varet nga gjendja e nënshtresës, materiali dhe sistemi teknik i përzgjedhur.**

Përderisa Paramasa nuk kërkon procesin specifik të pompimit me kapacitet dhe distanca të tilla, OE duhet të ketë mundësinë që punimet t'i realizojë me metoda dhe pajisje profesionale të përshtatshme me sistemin e paraparë.

AK nuk duhet ta shndërrojë **një metodologji të mundshme të realizimit** në kriter minimal eliminues pa treguar se ajo është e domosdoshme.

Kërkesa mund të eliminojë OE që kanë kapacitet të plotë për realizimin e dysHEMEVE

Një Operator Ekonomik mund të posedojë:

- miksera;

- pajisje për përgatitjen e nënshtresës;
- pajisje për nivelizim;
- vegla profesionale për aplikimin e dysHEMEVE;
- personel të kualifikuar;
- dhe të gjithë kapacitetin e nevojshëm për realizimin e pozicioneve të Paramasës,

por të eliminohet vetëm sepse nuk posedon apo nuk ka marrë me qira një pajisje që arrin njëkohësisht:

4 m³/orë + 150 m horizontalisht + 50 m vertikalisht.

Në këtë mënyrë, kriteri nuk mat nëse OE mund t'i realizojë dysHemetë sipas Paramasës, por nëse disponon **një makineri me performancë të caktuar që nuk është lidhur me punimet konkrete.**

Kërkesa krijon barrë të panevojshme në fazën e tenderimit

OE që nuk posedon një pajisje me këto karakteristika duhet të sigurojë marrëveshje qiraje/huazimi specifikisht për këtë projekt.

Kështu, një operator që mund t'i realizojë të gjitha punimet e dysHEMEVE me pajisjet dhe metodologjinë që posedon, detyrohet të sigurojë një makineri shtesë vetëm për të plotësuar kriterin formal.

Kjo krijon shpenzim dhe barrë administrative pa u dëshmuar se pajisja do të përdoret realisht gjatë ekzekutimit.

Shkelja e Nenit 51 të LPP-së

Neni 51 i LPP-së kërkon që kriteret e përzgjedhjes të kufizohen vetëm në ato që janë të nevojshme për të siguruar se operatorët ekonomikë posedojnë aftësitë profesionale, financiare dhe teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. **Neni 51.3 kërkon që kriteret, dokumentet dhe informatat e kërkuara të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës.**

Në rastin konkret, nuk është dëshmuar lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet punimeve të dysHEMEVE dhe kërkesës që OE të disponojë një pajisje me performancë:

4 m³/orë + 150 m horizontalisht + 50 m vertikalisht.

Për këtë arsye, kriteri nuk e kalon testin e relevancës dhe proporcionalitetit të kërkuar nga Neni 51.

Shkelja e Nenit 69 të LPP-së

Neni 69.1 i LPP-së lejon AK-në të kërkojë dëshmi për aftësinë teknike dhe profesionale, por vetëm “**nëse është relevante dhe e nevojshme**”. Për kontratat e punëve, Neni 69.6.3 lejon kërkimin e raportit për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që OE ka në dispozicion për realizimin e projektit.

Pra, mundësia ligjore që AK të kërkojë pajisje nuk është e pakufizuar.

AK duhet të jetë në gjendje të tregojë **përse pajisja konkrete dhe parametrat e saj konkretë janë relevantë dhe të nevojshëm për kontratën konkrete.**

Në këtë rast nuk është treguar:

- cili pozicion kërkon pompimin;
- cili material duhet të pompohet;
- çfarë sasi duhet të pompohet;
- pse kërkohen 4 m³/orë;
- pse kërkohen 150 m horizontalisht;
- dhe pse kërkohen 50 m vertikalisht.

Shkelja e Nenit 25.17 të Rregullores për Prokurimin Publik

Neni 25.17 i Rregullores Nr. 001/2022, në versionin e konsoliduar me ndryshimet e Rregullores Nr. 002/2024, përcakton shprehimisht se të gjitha kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Kjo dispozitë është drejtpërdrejt relevante për kriterin e kundërshtuar.

AK nuk ka përcaktuar vetëm një kapacitet të përgjithshëm për realizimin e dyshemeve, por ka kërkuar një pajisje me **tre parametra të veçantë teknikë**, asnjëri prej të cilëve nuk është lidhur me një sasi apo pozicion konkret të Paramasës.

Neni 25.18 i Rregullores

Neni 25.18 kërkon që gjatë formulimit të kërkesave minimale AK të kujdeset që të mos përjashtojë operatorë që posedojnë **aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike.**

Një OE që është plotësisht i aftë të realizojë dyshemetë e tenderuara, por që nuk posedon një pompë/makineri me performancën specifike të kërkuar, nuk duhet të konsiderohet teknikisht i paaftë nëse Paramasa vetë nuk e kërkon atë teknologji.

Kërkesa është më e gjerë se nevoja reale e kontratës

Në përmbledhje, problemi nuk qëndron vetëm te emërtimi i pajisjes, por te fakti se AK ka vendosur **tre kufij teknikë kumulativë** pa i lidhur me:

- volumen e punimeve;
- lartësinë reale të objektit;
- distancën reale të transportit;
- llojin e materialit;
- metodologjinë e përcaktuar në Projektin Ekzekutues;
- apo afatin e realizimit.

Kjo e bën kriterin **dukshëm më specifik dhe më kufizues** sesa është e nevojshme për të vërtetuar aftësinë teknike të OE-së.

Kërkesa ndaj AK-së

Për arsyet e lartcekura, **kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta largojë në tërësi nga lista e pajisjeve minimale kërkesën:**

“Pajisje për nivelizim, kapaciteti minimum 4 m³ në orë, distanca e dërgesës horizontal minimum 150 m, distanca e dërgesës vertikal minimum 50 m.”

PRETENDIMI NR.19

Kërkesa e AK-së “Kabinë toaleti – 1 copë.”

Dëshmia e kërkuar

Për kabinën e toaletit kërkohet që Operatori Ekonomik ta dëshmojë posedimin përmes **dokumentit të pronësisë**, ndërsa në rast se nuk është në pronësi të OE-së, kërkohet **marrëveshje për marrjen me qira/huazim në emër të këtij projekti, me validitet për tërë kohëzgjatjen e kontratës.**

Shkeljet e AK-së

Nga Paramasa e punimeve nuk rezulton ndonjë pozicion i veçantë për:

- furnizimin e kabinës mobile të toaletit;
- vendosjen e saj në punishte;
- mirëmbajtjen e saj;
- apo përdorimin e saj si pjesë e ndonjë pozicioni të matshëm të punimeve.

Nuk kontestohet se gjatë realizimit të punimeve Autoriteti Kontraktues dhe kontraktuesi duhet të sigurojnë që organizimi i punishtes të jetë në përputhje me kërkesat e sigurisë, higjienës dhe kushteve të punës.

Megjithatë, çështja që duhet të vlerësohet është **nëse kabina mobile e toaletit përbën aftësi teknike minimale që OE duhet ta dëshmojë që në fazën e tenderimit**, apo nëse ajo është një element i organizimit të kantierit që duhet të sigurohet nga kontraktuesi gjatë ekzekutimit të kontratës.

Në rastin konkret, konsiderojmë se kabina e toaletit i përket kategorisë së dytë.

Kabina e toaletit nuk dëshmon aftësinë teknike të OE-së për realizimin e punimeve

Kriteret e aftësisë teknike duhet të shërbejnë për të vërtetuar se OE ka kapacitetet profesionale dhe teknike që janë të nevojshme për realizimin e punimeve të tenderuara.

Neni 51 i LPP-së kërkon që kriteret e përzgjedhjes të kufizohen vetëm në ato që janë të nevojshme për të siguruar se operatori posedon aftësinë profesionale, financiare dhe

teknike për përmbushjen e kontratës, ndërsa paragrafi 3 kërkon që kriteret dhe dokumentet e kërkuara të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës.

Kabina mobile e toaletit nuk është pajisje me të cilën realizohen:

- demolimet;
- punimet ndërtimore;
- instalimet elektrike;
- hidroinstalimet;
- punimet makinerike;
- punimet e kulmit;
- suvatimet;
- ngjyrosjet;
- apo ndonjë pozicion tjetër teknik i Paramasës.

Pra, posedimi i saj **nuk tregon nëse OE ka ose nuk ka aftësi teknike për realizimin e objektit të kontratës.**

Një operator mund të posedojë personelin, mekanizimin, pajisjet profesionale dhe përvojën e nevojshme për realizimin e kontratës, por të mos ketë në pronësi një kabinë mobile toaleti. Kjo nuk e bën atë teknikisht të paaftë për realizimin e punimeve.

Neni 69 nuk e arsyeton trajtimin e çdo pajisjeje të kantierit si kriter kualifikimi

Neni 69.1 i LPP-së lejon AK-në të kërkojë dëshmi për aftësinë teknike dhe profesionale vetëm kur ato janë **relevante dhe të nevojshme**, ndërsa për kontratat e punëve Neni 69.6.3 lejon kërkimin e raportit mbi mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që OE ka në dispozicion për realizimin e projektit.

Megjithatë, kjo dispozitë nuk duhet të interpretohet në kuptimin që **çdo element fizik që mund të gjendet në kantier duhet të vendoset si pajisje minimale për kualifikim.**

Duhet të bëhet dallimi ndërmjet:

pajisjeve teknike të nevojshme për realizimin e punëve

dhe

elementeve të organizimit të përkohshëm të kantierit që kontraktuesi duhet t'i sigurojë gjatë ekzekutimit të kontratës.

Kabina e toaletit, për nga natyra dhe funksioni i saj, nuk kryen ndonjë operacion ndërtimor. Ajo shërben për sigurimin e kushteve higjienike dhe të organizimit të punishtes.

Prandaj, kërkesa që OE ta posedojë apo ta ketë të kontraktuar me qira që në fazën e tenderimit nuk është mjeti më proporcional për të garantuar që gjatë realizimit të kontratës do të sigurohen kushtet për punëtorët.

Vetë LPP-ja parashikon mekanizmin e duhur: kushtet e ekzekutimit të kontratës

Në këtë pretendim është veçanërisht relevant **Neni 31 i LPP-së – “Ekzekutimi i kontratave”**.

Sipas Nenit 31.1, Autoriteti Kontraktues mund të vendosë kërkesa të veçanta lidhur me mënyrën se si duhet të ekzekutohet kontrata, me kusht që ato të mos shkelin parimet e Nenit 7 dhe të jenë të paraqitura në Dosjen e Tenderit. Vetë dispozita përcakton se kërkesa të tilla mund të synojnë sigurimin e një niveli të caktuar të **kushteve të punës**. Neni 31.2 përmend shprehimisht kushtet që lidhen me **mbrojtjen e punëtorëve dhe kushtet e punës**.

Kjo dispozitë i jep AK-së një mënyrë më të përshtatshme dhe më proporcionale për ta trajtuar çështjen.

Nëse AK konsideron se për këtë kantier duhet domosdoshmërisht të ekzistojë një kabinë mobile toaleti, mund të përcaktojë në Dosjen e Tenderit dhe në kushtet e kontratës, për shembull, se:

“Kontraktuesi është i obliguar që para fillimit të punimeve të sigurojë dhe vendosë në punishte një kabinë sanitare/toaleti të përshtatshme për nevojat e personelit dhe ta mirëmbajë atë gjatë gjithë periudhës së realizimit të punimeve.”

Në këtë mënyrë arrihet plotësisht qëllimi i AK-së.

Por nuk është e nevojshme që OE, **para se ta fitojë kontratën**, të dëshmojë se:

- e posedon kabinën;
- ose ka lidhur marrëveshje qiraje;
- dhe se marrëveshja është e vlefshme për tërë kohëzgjatjen e projektit.

Kërkesa në formën aktuale mund të krijojë marrëveshje qiraje vetëm për qëllime të tenderimit

Kërkesa aktuale ka efektin që çdo OE që nuk posedon një kabinë mobile toaleti duhet të sigurojë paraprakisht një marrëveshje qiraje/huazimi në emër të projektit.

Kjo mund ta detyrojë operatorin të lidhë marrëveshje për një pajisje të organizimit të kantierit **para se të dihet nëse do t'i jepet kontrata**.

Në praktikë, kjo nuk dëshmon ndonjë kapacitet teknik të veçantë të OE-së. Ajo dëshmon vetëm se OE ka gjetur një subjekt të gatshëm t'ia japë një kabinë me qira.

Nëse OE shpallet fitues, sigurimi i një kabine të tillë mund të bëhet para mobilizimit dhe fillimit të punimeve, pa cenuar në asnjë mënyrë realizimin e kontratës.

Pikërisht për këtë arsye, kërkesa është më e përshtatshme si **detyrim i mobilizimit dhe organizimit të kantierit**, sesa si kriter eliminues i fazës së kualifikimit.

Shkelja e Nenit 25.17 të Rregullores për Prokurimin Publik

Neni 25.17 i Rregullores Nr. 001/2022, në versionin e konsoliduar me Rregulloren Nr. 002/2024, përcakton se të gjitha kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Në rastin konkret, ekziston dallim ndërmjet relevancës së **sigurimit të kushteve sanitare gjatë ekzekutimit** dhe relevancës së **posedimit paraprak të kabinës si kriter kualifikimi**.

E para mund të jetë plotësisht e arsyeshme.

E dyta nuk është domosdoshmërisht proporcionale.

Qëllimi i AK-së mund të arrihet me një masë më pak kufizuese: duke e obliguar fituesin që ta sigurojë kabinën para fillimit të punimeve.

Shkelja e Nenit 25.18 të Rregullores

Neni 25.18 obligon AK-në që gjatë formulimit të kërkesave minimale të kualifikimit të kujdeset që të mos përjashtohen operatorë që posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike.

Një OE që posedon të gjitha kapacitetet reale për realizimin e kontratës nuk duhet të konsiderohet teknikisht i paaftë vetëm për shkak se në momentin e tenderimit nuk ka në pronësi apo të marrë me qira një kabinë mobile toaleti.

Shkelja e Nenit 7 të LPP-së

Neni 7 kërkon trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues dhe ndalon që aktiviteti i prokurimit të zhvillohet në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën.

Në rastin konkret, vendosja si kriter eliminues e një elementi që mund të sigurohet lehtësisht gjatë mobilizimit, pa qenë tregues i kapacitetit teknik të OE-së, krijon një pengesë shtesë që nuk është e nevojshme për arritjen e qëllimit të AK-së.

Dallimi kryesor: nuk kërkojmë që AK ta heqë detyrimin sanitar, por ta vendosë në fazën e duhur

Pretendimi ynë **nuk është se kontraktuesi nuk duhet të sigurojë kushte sanitare për punëtorët.**

Pretendimi është se AK e ka vendosur këtë kërkesë **në kategorinë dhe fazën e gabuar të procedurës.**

Nëse kabina sanitare është e domosdoshme për organizimin e punishtes, ajo mund dhe duhet të trajtohet si:

kusht i ekzekutimit të kontratës / kërkesë e organizimit të kantierit,

dhe jo si:

pajisje minimale për kualifikimin teknik të OE-së.

Ky dallim është në përputhje edhe me strukturën e LPP-së: kriteret e përzgjedhjes rregullojnë aftësinë e OE-së, ndërsa Neni 31 lejon AK-në të përcaktojë kërkesa që lidhen me mënyrën e ekzekutimit dhe kushtet e punës.

Kërkesa ndaj AK-së

Për arsytet e lartcekura, **kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që kërkesën:**

“Kabinë toaleti – 1 copë”

ta largojë nga lista e pajisjeve/mekanizmit minimal që duhet të dëshmohet si kriter i aftësisë teknike në fazën e tenderimit.

Nuk kërkojmë domosdoshmërisht heqjen e obligimit për sigurimin e kushteve sanitare gjatë realizimit të kontratës.

Nëse AK konsideron se kabina mobile e toaletit është e nevojshme për organizimin e punishtës dhe mbrojtjen e kushteve të punës, kërkojmë që ajo të përcaktohet si **kusht i ekzekutimit të kontratës**, në përputhje me Nenin 31 të LPP-së, për shembull:

“Operatori Ekonomik i shpallur fitues, para fillimit të punimeve, obligohet të sigurojë dhe vendosë në punishte së paku një kabinë sanitare/toaleti adekuate për personelin dhe ta mbajë funksionale gjatë periudhës së realizimit të punimeve.”

PRETENDIMI NR.20

Kërkesa e AK-së “Makinë vetëshkarkuese max. 5 ton – 1 copë.”

Dëshmia e kërkuar

Për mjetin që i nënshtrohet regjistrimit, Autoriteti Kontraktues kërkon **librezë valide të regjistrimit/dokument pronësie**, ndërsa për mjetin që nuk është në pronësi të Operatorit Ekonomik kërkohet **marrëveshje për marrjen me qira/huazim në emër të këtij projekti, me validitet për tërë kohëzgjatjen e kontratës.**

Shkeljet e AK-së

Nga shqyrtimi i Paramasës rezulton se gjatë realizimit të kontratës krijohen materiale dhe mbeturina nga demolimet, demontimet dhe punimet e renovimit, të cilat duhet të **grumbullohen, ngarkohen, transportohen dhe largohen deri në vendin e caktuar.**

Për rrjedhojë, nuk kontestohet se OE duhet të ketë **kapacitet të mjaftueshëm transportues për largimin e materialeve dhe mbeturinave ndërtimore.**

Megjithatë, nga kjo nevojë funksionale nuk rezulton domosdoshmëria që OE të posedojë, si pajisje të veçantë minimale:

“Makinë vetëshkarkuese max. 5 ton – 1 copë.”

Paramasa përcakton rezultatin që duhet të arrihet – **largimin dhe transportimin e mbeturinave** – por nuk përcakton që ky funksion duhet të realizohet pikërisht me një makinë vetëshkarkuese deri në 5 ton.

Paramasa nuk identifikon punë të veçantë që kërkon pikërisht këtë mjet

Në dokumentacionin teknik nuk është identifikuar:

- pozicion i posaçëm për transport me makinë vetëshkarkuese;
- kategori e veçantë e materialit që mund të bartet vetëm me këtë mjet;
- distancë apo trase që e bën të domosdoshëm këtë konfigurim;
- sasi e veçantë mbeturinash që kërkon kapacitet pikërisht deri në 5 ton;
- apo aktivitet për të cilin një mjet tjetër transportues nuk do të ishte teknikisht i përshtatshëm.

Pra, kërkesa nuk është lidhur me një **pozicion konkret dhe të matshëm të Paramasës**, por me një mënyrë të caktuar të organizimit të transportit.

Funksioni i kërkuar mund të realizohet edhe me mjete të tjera transportuese

Funksioni real që i nevojitet projektit është:

ngarkimi, transportimi dhe largimi i materialeve dhe mbeturinave ndërtimore.

Ky funksion mund të realizohet me lloje të ndryshme të mjeteve transportuese, për sa kohë ato kanë kapacitet të përshtatshëm dhe përdoren në mënyrë të sigurt dhe profesionale.

Për këtë arsye, aftësia teknike e OE-së duhet të vlerësohet sipas faktit nëse ai disponon **kapacitet real dhe të mjaftueshëm transportues**, dhe jo sipas faktit nëse posedon një variant të caktuar të automjetit.

Një OE mund të posedojë mjet tjetër transportues me funksion dhe kapacitet të barasvlershëm apo më të lartë dhe të jetë plotësisht i aftë për realizimin e kontratës, por sipas formulimit aktual të eliminohet vetëm pse nuk posedon pikërisht “**makinë vetëshkarkuese max. 5 ton**”.

Kërkesa paraqet mbivendosje të kapacitetit transportues

Në listën e pajisjeve minimale, AK ka kërkuar edhe mjete të tjera që kryejnë funksione të transportimit, ngarkimit ose shkarkimit të materialeve.

Ky fakt është relevant vetëm për të vlerësuar domosdoshmërinë e **kësaj kërkesë konkrete**, sepse tregon se kapaciteti transportues i OE-së po kërkohet të dëshmohet përmes disa mjeteve të veçanta.

Megjithatë, Paramasa nuk përcakton:

- ndarje të punimeve sipas secilit mjet;
- kategori të veçanta mbeturinash për secilin automjet;

- punë simultane që kërkojnë patjetër angazhimin paralel të të gjitha mjeteve;
- apo sasi dhe dinamikë të punimeve që e bëjnë të domosdoshme një makinë vetëshkarkuese shtesë si kriter të veçantë.

Për këtë arsye, kërkesa për këtë automjet nuk është arsyetuar si **kapacitet shtesë i domosdoshëm**, por paraqitet si mbivendosje e funksionit të përgjithshëm të transportit.

Kufizimi “max. 5 ton” nuk është arsyetuar teknikisht

AK ka përcaktuar gjithashtu:

“max. 5 ton”.

Nga Paramasa nuk rezulton ndonjë bazë teknike që shpjegon pse mjete duhet të ketë kapacitet maksimal deri në 5 ton.

Nuk është identifikuar:

- kufizim i rrugës së qasjes;
- kufizim i ngarkesës së terrenit;
- kufizim konstruktiv;
- kufizim i hapësirës së manovrimit;
- dimension i hyrjes në kantier;
- apo ndonjë rrethanë tjetër që do ta bënte të papërshtatshëm një mjet me kapacitet më të madh se 5 ton.

Për rrjedhojë, një OE që disponon, për shembull, një makinë vetëshkarkuese me kapacitet 6 apo 7 ton mund të përjashtohet vetëm për faktin se mjete i tij ka **kapacitet më të madh**, edhe pse mund të kryejë plotësisht funksionin e kërkuar.

Një kufizim maksimal i tillë duhet të ketë bazë konkrete teknike. Në mungesë të saj, ai nuk dëshmon aftësi minimale, por vetëm kufizon gamën e pajisjeve të pranueshme.

Kërkesa përcakton inventarin e OE-së në vend të kapacitetit funksional

AK ka të drejtë të sigurohet që kontraktuesi i ardhshëm ka mekanizimin e nevojshëm për realizimin e punimeve.

Megjithatë, kjo nuk duhet të shndërrohet në përcaktim të hollësishëm të **inventarit të automjeteve që secili OE duhet ta posedojë ose ta marrë me qira**, nëse të njëjtat punë mund të kryhen me mjete teknikisht ekuivalente.

Në rastin konkret, qëllimi i ligjshëm i AK-së mund të arrihet duke kërkuar:

kapacitet adekuat për ngarkimin dhe transportimin e materialeve dhe mbeturinave,

pa e kushtëzuar këtë kapacitet me një automjet shtesë të tipit të caktuar.

Shkelja e Nenit 7 të LPP-së

Sipas **Nenit 7 të LPP-së**, AK duhet t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe nuk duhet të zhvillojë aktivitetin e prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën.

Kërkesa për një mjet të veçantë transportues, pa u dëshmuar nevoja konkrete për të, mund të eliminojë OE që disponojnë kapacitete të tjera transportuese plotësisht të përshtatshme për realizimin e kontratës.

Shkelja e Nenit 51 të LPP-së

Sipas **Nenit 51 të LPP-së**, kriteret e përzgjedhjes duhet të jenë të kufizuara në ato që janë të nevojshme për vërtetimin e aftësisë profesionale dhe teknike, ndërsa kriteret dhe dëshmitë e kërkuara duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës**.

Në rastin konkret:

- **kapaciteti për transportimin e mbeturinave është relevant;**
- **por posedimi i veçantë i një makine vetëshkarkuese max. 5 ton nuk është dëshmuar si i domosdoshëm.**

Pra, AK mund ta arrijë të njëjtin qëllim përmes një kriteri më pak kufizues dhe funksional.

Shkelja e Nenit 69 të LPP-së

Neni 69 i LPP-së i mundëson AK-së të kërkojë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që OE ka në dispozicion për realizimin e projektit.

Megjithatë, mjetet e kërkuara duhet të jenë **relevante dhe të nevojshme për kontratën konkrete**.

Në këtë rast, nuk është dëshmuar pse funksioni i transportit kërkon domosdoshmërisht edhe një makinë vetëshkarkuese të veçantë me kufizim maksimal 5 ton, në vend të një kapaciteti të përgjithshëm dhe të mjaftueshëm transportues.

Shkelja e Nenit 25.17 të Rregullores për Prokurimin Publik

Sipas **Nenit 25.17 të Rregullores për Prokurimin Publik**, kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës**.

Kërkesa në fjalë nuk është arsyetuar me një pozicion të veçantë të Paramasës dhe nuk është dëshmuar se pa këtë mjet konkret OE nuk do të ishte në gjendje të realizonte largimin e mbeturinave.

Shkelja e Nenit 25.18 të Rregullores

Sipas **Nenit 25.18**, gjatë përcaktimit të kërkesave minimale AK duhet të shmangë përjashtimin e operatorëve që posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike.

Një OE që ka kapacitet të mjaftueshëm transportues për të gjitha mbeturinat e projektit nuk duhet të konsiderohet teknikisht i paaftë vetëm sepse nuk disponon edhe me këtë lloj të veçantë mjeti.

Për rrjedhojë, kriteri duhet të vlerësojë **kapacitetin real transportues të OE-së dhe jo numrin apo konfigurimin formal të automjeteve që ai ka në inventar.**

Kërkesa ndaj AK-së

Për arsyet e lartcekura, **kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta largojë si kërkesë të veçantë nga lista e pajisjeve minimale kriterin:**

“Makinë vetëshkarkuese max. 5 ton – 1 copë.”]

PRETENDIMI NR.21

Kërkesa e AK-së

“Sharrë hidraulike për prerjen e betonit, asfaltit dhe drurit që montohet në ekskavator.”

Dëshmia e kërkuar

Për pajisjen kërkohet që Operatori Ekonomik ta dëshmojë posedimin përmes **faturës së shoqëruar me dëshmi të transaksionit, DUD-it apo dokumentit tjetër përkatës të pronësisë.**

Në rast se pajisja nuk është në pronësi të OE-së, kërkohet **marrëveshje për marrjen me qira/huazim në emër të projektit, me validitet për tërë kohëzgjatjen e kontratës.**

Shkeljet e AK-së

Kërkesa e AK-së është tepër specifike, sepse nuk kërkon thjesht një pajisje adekuate për prerje apo demolim, por kërkon në mënyrë kumulative që pajisja:

- 1. të jetë sharrë hidraulike;**
- 2. të jetë e përshtatshme për prerjen e betonit;**
- 3. të jetë e përshtatshme për prerjen e asfaltit;**
- 4. të jetë e përshtatshme për prerjen e drurit; dhe**
- 5. të montohet në ekskavator.**

Nga Paramasa e punimeve nuk rezulton arsyetim teknik që e bën të domosdoshëm këtë konfigurim të veçantë.

Në Paramasë nuk ekzistojnë punime të asfaltit

Elementi më i qartë që dëshmon mungesën e lidhjes së drejtpërdrejtë me objektin e kontratës është fakti se Paramasa **nuk përmban pozicion për punime të asfaltit.**

Nuk është paraparë:

- demolim i asfaltit;

- prerje e asfaltit;
- hapje traseje në asfalt;
- largim i shtresave asfaltike;
- riparim i asfaltit;
- apo ndonjë aktivitet tjetër për të cilin nevojitet sharrë hidraulike për prerjen e asfaltit.

Për rrjedhojë, pjesa e kriterit që kërkon pajisje për **“prerjen e asfaltit”** nuk ka lidhje me ndonjë punë konkrete të tenderuar.

AK nuk mund ta arsyetojë një pajisje si kapacitet minimal vetëm sepse ajo mund të përdoret në përgjithësi në sektorin e ndërtimit. Kriteri duhet të lidhet me **punët konkrete që janë objekt i kontratës**.

Nuk është paraparë prerje masive e betonit me sharrë hidraulike të montuar në ekskavator

Paramasa përmban punime të demolimit, mirëpo nuk është identifikuar ndonjë pozicion që kërkon:

- prerje lineare të konstruksioneve masive prej betoni;
- prerje të pllakave të betonit me pajisje hidraulike;
- prerje të themeleve;
- prerje të elementeve masive të betonit të armuar;
- apo përdorimin e një sharre hidraulike të montuar në ekskavator.

Punimet e demolimit në Paramasë janë përshkruar në bazë të **rezultatit që duhet të arrihet**, pra demolimi dhe largimi i materialit, dhe jo përmes imponimit të teknologjisë së prerjes hidraulike.

Edhe për **demolimin e aneksit ngjitur me objektin**, Paramasa kërkon që puna të realizohet me kujdes dhe pa rrezikuar stabilitetin e objektit, por nuk përcakton se kjo mund të realizohet vetëm përmes një sharre hidraulike të montuar në ekskavator.

Për rrjedhojë, nëse një OE është në gjendje ta realizojë demolimin në mënyrë profesionale dhe të sigurt me pajisje të tjera adekuate, mungesa e pikërisht kësaj sharre nuk dëshmon mungesë të kapacitetit teknik.

Punimet me dru nuk e arsyetojnë këtë pajisje

Sa i përket komponentit:

“për prerjen e ... drurit”

Paramasa e punimeve të kulmit parasheh ndërhyrje dhe zëvendësime lokale të elementeve prej druri, përfshirë listelat dhe kundërlistelat.

Megjithatë, nuk ekziston pozicion që kërkon:

- prerje masive të konstruksionit prej druri;

- demolim mekanik të elementeve masive të drurit;
- prerje të drurit përmes pajisjes së montuar në ekskavator;
- apo teknologji hidraulike për realizimin e punimeve të kulmit.

Listelat dhe kundërlistelat janë elemente që mund të përpunohen me **pajisje profesionale të përshtatshme për punime druri**, pa qenë teknikisht e dëshmuar nevoja që prerja të realizohet me një sharrë hidraulike të montuar në ekskavator.

Prandaj, as pjesa e kriterit që lidhet me drurin nuk e arsyeton konfigurimin e kërkuar nga AK.

AK ka bashkuar tri funksione të ndryshme në një pajisje shumë specifike

Kërkesa bashkon:

BETON + ASFALT + DRU

në një pajisje të vetme, të cilës i shtohet edhe kushti:

“që montohet në ekskavator”.

Problemi këtu nuk është vetëm se pajisja është specifike. Problemi është se AK nuk ka treguar **përse secili prej këtyre tri funksioneve është i nevojshëm për kontratën konkrete.**

Në veçanti:

- për **asfaltin** nuk ekziston fare pozicion i identifikuar;
- për **betonin** nuk ekziston pozicion që kërkon metodën specifike të prerjes hidraulike;
- për **drurin** nuk rezulton nevoja për prerje me pajisje të montuar në ekskavator.

Kështu, kërkesa nuk është ndërtuar mbi nevojat reale të Paramasës, por mbi posedimin e një pajisjeje me konfigurim shumë të veçantë.

Kushti “që montohet në ekskavator” kufizon më tej mënyrën e realizimit

AK nuk është ndalur te funksioni i prerjes, por ka kërkuar që sharra:

“të montohet në ekskavator”.

Ky kusht përcakton edhe **mjetin bartës të pajisjes dhe metodologjinë e realizimit të punimeve.**

Paramasa nuk përcakton se prerjet apo demolimet duhet të realizohen me pajisje të montuar në ekskavator.

Nëse rezultati mund të arrihet me:

- sharrë profesionale për beton;

- pajisje për prerje;
- çekan demolues;
- pajisje hidraulike tjetër;
- mjete elektrike/pneumatike;
- ose mekanizëm tjetër profesional dhe ekuivalent,

atëherë nuk është proporcionale të konsiderohet teknikisht i papërshtatshëm OE vetëm sepse pajisja e tij **nuk montohet në ekskavator**.

Kërkesa mat posedimin e pajisjes specifike dhe jo kapacitetin real për demolim/prerje

Një OE mund të posedojë personel të kualifikuar dhe pajisje të plota për realizimin e të gjitha demolimeve dhe prerjeve të parashikuara me Paramasë, por të eliminohet vetëm sepse nuk posedon apo nuk ka marrë me qira:

“sharrë hidraulike për beton, asfalt dhe dru që montohet në ekskavator”.

Në këtë mënyrë, vlerësimi zhvendoset nga pyetja:

“A është OE teknikisht i aftë t'i realizojë punimet?”

te pyetja:

“A posedon OE pikërisht këtë konfigurim të pajisjes?”

Këto nuk janë e njëjta gjë.

Shkelja e Nenit 7 të LPP-së

Neni 7 i LPP-së kërkon trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues të operatorëve ekonomikë dhe ndalon zhvillimin e aktivitetit të prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën.

Vendosja e një pajisjeje shumë të specializuar si kriter minimal, kur një pjesë e funksioneve të saj nuk figuron fare në Paramasë dhe pjesa tjetër mund të realizohet përmes metodave të tjera profesionale, mund të kufizojë operatorët ekonomikë pa një arsye objektive të lidhur me realizimin e kontratës.

Shkelja e Nenit 51 të LPP-së

Neni 51 i LPP-së e lidh përcaktimin e kriterëve të përzgjedhjes me aftësitë që janë të nevojshme për realizimin e kontratës dhe kërkon që kriteret dhe dëshmitë të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës**.

Në rastin konkret, AK nuk ka dëshmuar relevancën dhe proporcionalitetin e kombinimit:

“sharrë hidraulike + beton + asfalt + dru + montim në ekskavator”.

Veçanërisht kërkesa për prerje të asfaltit nuk mund të konsiderohet drejtpërdrejt relevante nëse Paramasa nuk përmban punime asfaltike.

Shkelja e Nenit 69 të LPP-së

Neni 69 i LPP-së i mundëson AK-së të kërkojë dëshmi për aftësinë teknike dhe profesionale dhe për mjetet/pajisjet që OE ka në dispozicion, por këto kërkesa duhet të jenë **relevante dhe të nevojshme për realizimin e projektit konkret**.

Pra, e drejta për të kërkuar listë pajisjesh nuk e përjashton AK-në nga detyrimi për të treguar lidhjen ndërmjet **pajisjes së kërkuar dhe punëve konkrete të kontratës**.

Në këtë rast kjo lidhje nuk është dëshmuar në nivelin që do të justifikonte vendosjen e kësaj pajisjeje si kriter minimal eliminues.

Shkelja e Nenit 25.17 të Rregullores për Prokurimin Publik

Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, në versionin e konsoliduar me ndryshimet e Rregullores Nr. 002/2024, kërkon që kërkesat minimale për kualifikim të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës**.

Kërkesa e kundërshtuar nuk e plotëson këtë standard përderisa AK nuk ka identifikuar punë konkrete që kërkojnë të tria kapacitetet e pajisjes dhe, veçanërisht, nuk ka identifikuar asnjë punë asfaltike.

Shkelja e Nenit 25.18 të Rregullores

Rregullorja kërkon gjithashtu që kriteret minimale të mos formulohen në mënyrë që të përjashtojnë operatorë ekonomikë që posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike për realizimin e kontratës.

Një OE që disponon pajisje adekuate për demolimin, prerjen dhe përpunimin e materialeve të parashikuara realisht në projekt nuk duhet të eliminohet vetëm sepse nuk disponon një pajisje të vetme që kombinon **betonin, asfaltin dhe drurin** dhe që montohet pikërisht në ekskavator.

Kërkesa ndaj AK-së

Për arsyet e lartcekura, **kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta largojë në tërësi nga lista e pajisjeve minimale kërkesën:**

“Sharrë hidraulike për prerjen e betonit, asfaltit dhe drurit që montohet në ekskavator.”

PRETENDIMI NR.22

Kërkesa e AK-së

“Makinë shpuese për beton diametër shpues minimum 300 mm – 2 copë.”

Dëshmia e kërkuar

Për pajisjen kërkohet që Operatori Ekonomik ta dëshmojë posedimin përmes **dokumentit të pronësisë, faturës së shoqëruar me dëshmi të transaksionit, DUD-it apo dokumentit tjetër përkatës.**

Në rast se OE nuk i posedon pajisjet në pronësi, kërkohet **marrëveshje për marrjen me qira/huazim në emër të këtij projekti, me validitet për tërë kohëzgjatjen e kontratës.**

Shkeljet e AK-së

Nga shqyrtimi i Paramasës së instalimeve makinerike rezulton se projekti përfshin sisteme **VRF, ventilim, gypa të kondensatit, gypa bakri, kanale ventilimi dhe elemente të tjera përcjellëse të instalimeve.**

Nuk kontestohet se gjatë montimit të instalimeve makinerike mund të paraqitet nevoja për realizimin e **depërtimeve/shpimeve në mure, pllaka apo elemente të tjera të objektit.**

Megjithatë, kjo nevojë e përgjithshme nuk e arsyeton automatikisht kërkesën konkrete të AK-së që OE të posedojë:

dy (2) makina shpuese për beton, secila me kapacitet shpimi minimum Ø300 mm.

Problemi me kriterin është i dyfishtë:

së pari, nuk është arsyetuar kapaciteti **minimum Ø300 mm**; dhe **së dyti**, nuk është arsyetuar kërkesa për **2 copë**.

Paramasa nuk përmban pozicion të posaçëm për shpime Ø300 mm

Në Paramasën e analizuar nuk është identifikuar ndonjë pozicion i veçantë që përcakton:

- shpim në beton me diametër Ø300 mm;
- hapje të vrimave Ø300 mm për kanale ventilimi;
- core drilling Ø300 mm;
- numrin e depërtimeve me këtë diametër;
- trashësinë e elementeve të betonit që duhet të shpohen;
- apo ndonjë sasi të matshme të punimeve të shpimit me diametër të tillë.

Për rrjedhojë, nuk është e qartë **nga cili pozicion konkret i Paramasës është nxjerrë parametri “minimum 300 mm”.**

Nëse AK kërkon një kapacitet të caktuar të shpimit si kriter minimal, ai kapacitet duhet të jetë i lidhur me **dimensionet reale të instalimeve dhe depërtimeve të projektuara.**

Diametrat e instalimeve të evidentuara nuk arsyetojnë automatikisht Ø300 mm

Në pjesën e ventilimit janë evidentuar, ndër të tjera, lidhje fleksibile me diametra si:

Ø125 mm dhe Ø150 mm.

Kjo nuk do të thotë se në të gjithë projektin nuk mund të paraqitet asnjë depërtim më i madh, por tregon se **nga këto pozicione nuk mund të nxirret domosdoshmëria e një kapaciteti fiks minimum Ø300 mm.**

Nëse AK ka identifikuar kanale apo elemente të tjera që kërkojnë depërtime 300 mm ose më të mëdha, atëherë duhet të tregojë konkretisht:

- elementin që kalon përmes depërimit;
- dimensionin e tij;
- diametrin e vrimës së nevojshme;
- numrin e depërtimeve;
- dhe pozicionin përkatës të Paramasës/Projektit Ekzekutues.

Pa këtë lidhje teknike, shifra **Ø300 mm** mbetet një parametër i vendosur pa bazë të identifikueshme në dokumentacionin e tenderit.

Nevoja për shpime nuk është e njëjtë me nevojën për kapacitet minimum Ø300 mm

Është me rëndësi të bëhet dallimi ndërmjet dy çështjeve:

nevojës për pajisje për shpime/core drilling, e cila mund të jetë relevante për instalimet, dhe

kërkesës që pajisja të ketë patjetër kapacitet minimum Ø300 mm, e cila duhet të arsyetohet me projektin.

Një Operator Ekonomik mund të posedojë pajisje profesionale për realizimin e të gjitha depërtimeve reale të parashikuara nga projekti, por të mos posedojë një makinë të dimensionuar për Ø300 mm.

Nëse diametrat realë të nevojshëm janë më të vegjël, OE do të mund të realizonte plotësisht kontratën, por megjithatë do të eliminohej vetëm sepse pajisja e tij nuk arrin një kapacitet që **nuk është dëshmuar se kërkohet nga punimet.**

Kjo do të thotë se kriteri nuk vlerëson vetëm aftësinë për realizimin e depërtimeve të projektit, por kërkon edhe **rezervë kapaciteti të pambështetur me nevojë konkrete.**

Nuk është arsyetuar kërkesa për dy makina shpuese

Edhe sikur AK të dëshmonte se për realizimin e kontratës nevojitet një pajisje për core drilling me kapacitet deri në Ø300 mm, mbetet e paarsyetuar kërkesa:

“2 copë”.

Paramasa nuk përcakton:

- dy fronte të njëkohshme të punimeve të shpimit;
- dy ekupe që duhet të kryejnë shpime paralelisht;
- numër të madh të depërtimeve që kërkon dy makina;

- afat të posaçëm që nuk mund të përmbushet me një pajisje;
- apo ndonjë dinamikë pune që e bën të nevojshme disponueshmërinë simultane të dy makinave.

Prandaj, AK duhet ta arsyetojë **veçmas sasinë prej dy pajisjeve**, dhe jo vetëm nevojën e përgjithshme për shpime.

Fakti që një pajisje mund të jetë relevante nuk nënkupton automatikisht se **dy pajisje identike duhet të jenë kriter minimal eliminues**.

Kërkesa kombinon kapacitet të lartë teknik me sasi të dyfishtë

Në formën aktuale, OE nuk duhet vetëm të dëshmojë se është në gjendje të realizojë shpime në beton.

Ai duhet të dëshmojë njëkohësisht se disponon:

2 × makina shpuese, secila me diametër shpues minimum Ø300 mm.

Kështu kriteri krijon një kapacitet të përgjithshëm teknik dukshëm më të lartë sesa do të rezultonte nga një kërkesë e zakonshme funksionale për realizimin e depërtimeve të instalimeve.

Në mungesë të sasive, diametrave dhe dinamikës së punimeve që e mbështesin këtë kapacitet, kërkesa krijon barrë të panevojshme për OE-të.

OE mund të detyrohet të marrë me qira pajisje që nuk do t'i përdorë

Për shkak të mënyrës së dëshmimit, OE që nuk posedon dy makina me kapacitet minimum Ø300 mm duhet të sigurojë marrëveshje qiraje/huazimi për projektin.

Kjo mund të detyrojë një operator që posedon pajisje plotësisht të mjaftueshme për diametrat realë të instalimeve:

- të sigurojë pajisje shtesë;
- të sigurojë edhe një pajisje të dytë;
- dhe të marrë përsipër obligime qiraje,

vetëm për t'iu përshtatur një kriteri, pa qenë dëshmuar se kapaciteti Ø300 mm dhe dyfishimi i pajisjes do të nevojiten gjatë realizimit.

Shkelja e Nenit 51 të LPP-së

Neni 51 i LPP-së përcakton se kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në ato që janë të nevojshme për të siguruar se OE posedon aftësitë profesionale, financiare dhe teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. Po ashtu, kriteret, dokumentet dhe informatat e kërkuara duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës**.

Në rastin konkret, pajisja për shpime mund të ketë relevancë me instalimet, por AK duhet të dëshmojë proporcionalitetin e **parametrave konkretë**:

Ø300 mm + 2 copë.

Nuk mjafton që AK të provojë se gjatë projektit mund të ketë shpime. Duhet të provojë pse pikërisht ky diametër dhe kjo sasi janë të nevojshme.

Shkelja e Nenit 69 të LPP-së

Për kontratat e punëve, **Neni 69.6.3** i lejon AK-së të kërkojë raport mbi mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që OE i ka në dispozicion për realizimin e projektit.

Megjithatë, kjo mundësi duhet të përdoret për të verifikuar **kapacitetin e nevojshëm për projektin konkret**, dhe jo për të imponuar parametra teknikë më të lartë se ata që mund të arsyetohen nga punimet.

Në këtë rast, AK nuk ka lidhur:

- Ø300 mm me një depërtim konkret; dhe
- 2 copë me një nevojë konkrete për punë simultane.

Prandaj, kërkesa në formën aktuale tejkalon atë që është e nevojshme për vërtetimin e aftësisë teknike.

Shkelja e Nenit 25.17 të Rregullores për Prokurimin Publik

Neni 25.17 i Rregullores Nr. 001/2022, në versionin e konsoliduar me Rregulloren Nr. 002/2024, përcakton se të gjitha kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Ky standard duhet të zbatohet jo vetëm ndaj emrit të pajisjes, por edhe ndaj:

- kapacitetit të saj;
- dimensioneve teknike;
- dhe numrit të njësive të kërkuara.

Pra, AK duhet të jetë në gjendje të arsyetojë jo vetëm “makinë shpuese”, por **pikërisht Ø300 mm dhe pikërisht dy copë.**

Neni 25.18 i Rregullores

Neni 25.18 kërkon që gjatë formulimit të kërkesave minimale AK të kujdeset që të mos përjashtohen operatorë që posedojnë **aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike.**

Një OE që disponon pajisje profesionale për realizimin e të gjitha diametrave realë të depërtimeve të parashikuara nga projekti nuk duhet të konsiderohet teknikisht i paaftë vetëm sepse:

- pajisja e tij nuk arrin Ø300 mm, kur ky diametër nuk është dëshmuar si i nevojshëm; ose

- disponon një pajisje në vend të dy pajisjeve, kur nuk është dëshmuar nevoja për punë të njëkohshme.

Kriteri duhet të lidhet me diametrat realë të instalimeve

Mënyra proporcionale për ta formuluar kërkesën është që AK të kërkojë **aftësi për realizimin e shpimeve dhe depërtimeve që realisht dalin nga Projekti Ekzekutues dhe Paramasa.**

Nëse në projekt ekzistojnë depërtime me diametra të ndryshëm, pajisja duhet të jetë e aftë t'i realizojë ato diametra.

Nuk është e nevojshme që AK të vendosë një kufi arbitrar Ø300 mm nëse diametri më i madh real është më i vogël.

Po ashtu, nuk është e nevojshme të kërkojen dy makina nëse vëllimi dhe dinamika e punimeve mund të realizohen me një pajisje.

Kërkesa ndaj AK-së

Për arsyet e lartcekura, **kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta largojë kriterin në formën aktuale:**

“Makinë shpuese për beton diametër shpues minimum 300 mm – 2 copë.”

PRETENDIMI NR.23

Kërkesa e AK-së

“Kompresor ajri me hilt për thyerje të betonit minimum 550 kg – 1 copë.”

Dëshmia e kërkuar

